

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 246, Prill 2024
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

23 PRILL DITA NDËRKOMBËTARE E LIBRIT

LIBRI I PASHKRUAR I PETRO MARKOS

Dy ose tre javë nuk e takova më Petron (Marko) edhe pse dilja pothuajse çdo mbrëmje nga Kafeneja e Gazetarëve. Nuk e pashë as në bulevard ku bënte shëtitjen e tij të zakonshme. Mendova i shqetësuar se mos ishte i sëmurë, por aty për aty e ngushëllova veten: ndoshta është ulur e po shkruan, mendova. Kur e pashë një të shtunë në bulevard, më mbetën sytë të kaçurrelat e thinjur e të pakrehur. ...

LIBRI, DRITAREJA E HAPUR DREJT DIJES 2

Data 23 prill është shpallur "Dita Botërore e Librit" dhe kremtohet si e tille ne krejt pjesën intelektuale të shoqërisë. Më 15 nëntor të 1995 me një rezolutë të UNESCO-s, pasi u morën në konsideratë faktet se, libri ka qenë, historikisht, instrumenti më i fuqishëm i shpërndarjes së njohurive dhe mjete më efikas, për të siguruar ruajtjen e këtyre njohurive, se çdo nismë për promovimin ...



Petro Marko

Heroina Marije Shllaku u përjetësua në qytetin e Pejës 3



Zëri i vëllazërisë bashkoi këngëtarë, valltarë, 5 veprimtarë e artistë nga trojet etnike

Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" ka vijuar të organizojë edhe këtë vit Manifestimin tradicional "Zëri i Vëllazërisë-2024". Kësaj radhe kjo veprimtari kulturor u organizua në mbështetje e në bashkëorganizim me komunën e Istogut, duke bërë bashkë këngëtarë, valltarë, veprimtarë e artistë nga Shkodra, Postriba, Tuzi dhe nga qytete të Dukagjinit të Kosovës.

Molla e Shoshit si Kruja e 6 Kastrotit...

- AMANETI I MARK MHILLIT
SOT BERI
QË AI TË PREHET I QETË NË
MOLLË TË SHOSHIT -

Me datën 19 prill 2024, Molla e Shoshit kishte një ditë veçante, se Ajo mbledhi banoret e vet dhe shpali një pjesë të historisë së saj të lavdishme nëpërmes birit të vet, Mark Mhill Fushazi në një ceremoni mortore me rastin e rivarrimit të eshtrave të atdhetarit të pashoq, patriotit guximtar, qendrestari të pathyeshëm, luftëtarit pa kompromis, demokratit të paepur dhe besimtarit të kulluar, Mark Mhilli, i organizuar e drejtuar nga At' Anton Kodrari.

I gjithë Shoshi kishte ditë të veçante, sepse krenohet me këtë burrë!

Kishin ardhur nga gjitha fiset e Dukagjinit, burra të nderuar ...

DHUNA DHE KRIMI NDAJ GRAVE, RASTËSOR APO STRATEGJIK? 13

-BASHKËBISEDIM ME
SOCIOLOGUN GËZIM TUSHI,
"MJESHËR I MADH"
DHE "KALORËS I URDHËRIT TË
SKËNDERBEUT"-

FRAN GJOKA

Kohët e fundit në vendin tonë ka një "fluks" të madh dhune në familje, që i kapërcen të gjithë kufijtë. Dhuna në familje ka vërtetuar se abuzimi ndaj grave është një problem kompleks dhe shumë dimensional. Kjo lidhet dhe me faktorët kulturorë, shoqërorë, familjarë dhe individualë, që ndikojnë në mundësitë që gratë të bëhen viktimat e dhunës. Për këtë ju drejtuam sociologut...

23 PRILL DITA NDËRKOMBËTARE E LIBRIT

Libri i pashkruar i Petro Markos

ESE NGA LAZER STANI

Dy ose tre javë nuk e takova më Petron (Marko) edhe pse dilja pothuajse çdo mbrëmje nga Kafeneja e Gazetarëve. Nuk e pashë as në bulevard ku bënte shëtitjen e tij të zakonshme. Mendova i shqetësuar se mos ishte i sëmurë, por aty për aty e ngushëllova veten: ndoshta është ulur e po shkruan, mendova. Kur e pashë një të shtunë në bulevard, më mbetën sytë te kaçurrelat e thinjur e të pakrehur. Palltoja që mbante veshur m'u duk më e vjetër se kurrë. I lodhur, i drobitur, hapat i hidhte ngadalë, po trupin e mbante drejt dhe nuk shihte as majtas as djathtas. Nuk pata guxim t'i flisja. M'u duk sikur do t'ia prishja atë udhëtim të vetmuar drejt askundit. Shkova dhe u ula në kafene, duke pritur se mos kthehej aty dhe ai me të vërtetë u kthye. U ngrita në këmbë sapo u fut në kafe dhe e përshëndeta. Erdhi drejt meje dhe më përqafoi si një bir të humbur. U ul në kolltukun e vjetër, ndërsa unë i bëra shenjë vajzës që t'i sillte kafënë.



"Lazër, nuk e marr vesh njeriun," më tha. Humbi në mendime, pastaj nxori paketën dhe ndezi një cigare. Unë në atë kohë nuk e pija duhanin. Ndiqja me sy currilin e hollë të tymit që dilte nga cigarja, bënte disa spërdredhje të mundimshme në ajrin e ndenjtur dhe humbiste në asgjë. "Si jetët tona," mendova.

"Dua të shkruaj një roman, më tha. Retë dhe Gurët. Gurët nuk lëvizin, qëndrojnë aty ku ishin përjetësisht, ndërsa retë vijnë dhe shkojnë, ikin dhe kthehen, duke derdhur lotët e të ikurve në gjollat e gurëve..."

Kapi mjekrën me dorën e majtë dhe e shtrëngoi mes gishtërinjve.

"Ja, tha, ta zëmë se janë dy vëllezër: njëri sa rritet merr rrugët e botës, ia mbath nga sytë këmbët, u bijën kryq e tërthor shteteve, shkollohet, dashuron, harbon, kurse vëllai tjetër, nuk shkulet nga fshati, kullot bagëtitë në mal, punon tokën, mban nënën dhe familjen. Po çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje, sytë i shkojnë nga deti, sheh renë që vjen prej andej, sjell shiun që derdhet mbi gurë. Atij ky shi i ngjan me lotët e dhimbjes së vëllait mërgimtar. Po jeta e cilit vëlla ka më kuptim? Nuk e marr vesh. Gjithmonë, edhe kam dashur edhe të ik, edhe të rri..."

U kthye nga unë dhe më pyeti se a shkruaja.

"Shkruaj, i thashë, po nuk kam botuar asnjë gjë. Dhe nuk besoj se do m'i botojnë ndonjëherë"

"Shkruaj, tha, shkruaj sa të mundesh. Unë nuk kam shkruar as pesë përqind të atyre që kam menduar". I shqiptoi këto fjalë me një zë të shuar, të pikëlluar, të pashpresë, sikur pas këtyre fjalëve pritej shkatërrimi, rrënimi, asgjëja.

"Na thuaj ndonjë gjë për të qeshur, m'u drejtua papritmas. Dhe unë i tregova historinë e sekretarit të parë dhe të kurvës që kërkonte shtëpi, që e kisha dëgjuar ato ditë. Qeshëm të dy, por Petro më fort. "I zgjuar kopili", tha dhe vazhdonte të qeshte.

Pasi u ndamë, unë mendjen e kisha te librat e tij të pashkruar, librat që do të mbeleshin përjetësisht të mbyllur në kafkën e tij. I imagjinoja në radhë njëri pas tjetrit, të vendosur në bibliotekën time; të rinj, të sapodalë nga shtypi, me kundërmimin e fortë të letrës. A do t'i shkruante ndonjëherë ata libra, a do t'i lexoja unë ndonjëherë?! E dija se, në atë moshë që ishte, nuk do t'ia dilte kurrë t'i shkruante, por të paktën atë romanin "Retë dhe Gurët", kisha përshtypjen se do ta lexoja ndonjë ditë. Ai me siguri po shkruante këtë roman, mendoja. Aty për aty u kujtova për të gjithë librat e mi që kisha në kokë dhe me marrëzinë e një të riu, mendova i ngazëllyer se kisha gjithë kohën e botës për t'i shkruar. Atëkohë nuk e dija se shkrimtari nuk arrin ta shkruajë kurrë librin e tij më të mirë dhe ai, libri më i mirë, si një vrimë e zezë gëlltit edhe shumë libra të tjerë rreth vetes. Librat më të mirë të shkrimtarit mbeten gjithmonë të pashkruar, misteret më të thella të pashprehura, ndjenjat më intime të ngujuara.

Kur u botuan kujtimet e Petros, pas vdekjes, nxitova të shkoj në librari e ta blej, sepse mbi koperinë ishte dhe titulli i romanit të munguar "Retë dhe Gurët". Ishte një bashkëbisedim i gjatë, me vetveten, një rrëfim për të trija kohët e jetës së tij, por jo libri i pashkruar i Petro Markos. Shkrimtari librin më të mirë të tij, atë të pashkruar e kishte marrë me vete, si një libër të mbyllur, që ne nuk do ta lexonim kurrë.

Fragment nga eseja "Libri i pashkruar"
për shkrimtarin Petro Marko

LIBRI, DRITAREJA E HAPUR DREJT DIJES

ESE NGA LULASH BRIGJA

Data 23 prill është shpallur "Dita Botërore e Librit" dhe kremtohet si e tille ne krejt pjesën intelektuale të shoqërisë.

Më 15 nëntor të 1995 me një rezolutë të UNESCO-s, pasi u morën në konsideratë faktet se, libri ka qenë, historikisht, instrumenti më i fuqishëm i shpërndarjes së njohurive dhe mjeti më efikas, për të siguruar ruajtjen e këtyre njohurive, se çdo nismë për promovimin e librave të rinj është një faktor i pasurimit kulturor e të tjera. Ideja e përkujtimit të Ditës Botërore të librit e ka origjinën e vet në Spanjë, në zonën e Katalonjës, ku atij, që blinte një libër i dhurohej edhe një trëndafil.

Më 23 prill të vitit 1616 u nda nga kjo botë Servantesi, Shekspiri dhe Garcilaso de la Vega, i mbiquajtur Inca. 23 prilli shënon edhe lindjen ose vdekjen e shkrimtarëve të tjerë, si Maurice Druon, K. Laxness, Vladimir Nabokov, Joseph Pla dhe Manuel Mejia Vallejo. Kjo është arsyeja, për të cilën

kjo datë domethënëse për letërsinë universale është caktuar nga Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s për t'i bërë homazh botëror librit dhe autorëve të tij dhe për të inkurajuar të rinjtë, që të zbulojnë kënaqësinë e të lexuarit, si edhe për të respektuar kontributin e pazëvendësueshëm, që kanë dhënë krijuesit për progresin social dhe atë kulturor.

Këto janë gjëra te njohura nga te gjitha, por opinioni im është se interesi për librin është në krizë.

Por kjo nuk me ndalon që te uroj Gëzuar

- Gëzuar Ditën e Librit!

Ju poet, artistë e shkrimtarë, ju jeni mjeku dhe drita e shpirtit njerëzor.

- Gëzuar Ditën e Librit!

Ju që lexoni, shkruani dhe shpërndani dije, pa ju bota do kishte luftë, varfëri dhe injorancë.

- Gëzuar Ditën e Librit!


Ju që politika ju dha pushtet pa lexuar kurrë një libër, Ju, që aventura ju bëri të pasur pa lexuar asnjë poezi.

- Gëzuar Ditën e Librit!

Ju Yje të showbiz, që na shitni antivlerat për modernizim.

- Gëzuar Ditën e Librit!

Vendi im i dashur ku Interneti dhe Analfabeti janë vëllezër!



Petro Marko

Heroina Marije Shllaku u përjetësua në qyetin e Pejës

Një bust për Marie Shllakun në Pejë... Heroina shkodrane, që dha jetën për Kosovën, në lule të rinisë.

Në Pejë u mbajt Akademi solemne më rastin e zbulimit të bustit të heroinës Marie Shllaku. Tema bosht e kësaj akademie ishte: Marie Shllaku Mbretëresha e nacionalizmës shqiptare”

Në lidhje më këtë Temë u lexuan shumë kumtesa që kishin të bënin me biografinë, veprimtarinë kombëtarë dhe luftën e vërtetë nacionale, kësaj zonjë të ngritur dhe të ditur. Ishte dëshmitari i gjallë e këtij gjyqi famëkeq z. Shefqet Kelmendi, i cili më mjaftë emocione dhe argumente sqaroi episodin nga ky gjyq antishqiptarë. Ne inaugurimin e bustit të Marie Shllakut moren pjesë gjithashtu edhe perfaqësues të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, N/kryetari I saj Prele Milani studiues,shkrimtar e publicist; Mark Gjeka publicist, e të tjerë.

Veprimtaria filloi ne sallën e keshillit komunal te Pejes.

Ligjeruan plote nga pjesemarrësit me nje ndjenje mjaft atdhetare. Ligjoroj dhe z. Prele Milani, duke ja kushtuar jetes dhe veprimtarise se heroines Marie Shllaku.

Më pas veprimtaria vijoi me zbulimin e bustit nga kryetari i komunes se Pejes z. Gazmend Muhaxheri e zyrtare dhe intelektual të tjere të ardhur nga treva të ndryshme mbare trojeve shqiptare.

Ne emer te Shoqates Atdhetare “Sukagjini”, Gjon Shtegu e KoleSukullari vendosen kurore pranë bustit të heroines Marie Shllaku.

Bija nga Shkodra, me origjine nga fshti Palaj të krahines së Shllakut, oficere ushtarake, poliglotë dhe stratege, që fliste dhe shkruante gjuhët: latine, frënge, gjermane, italiane, gjuhën e vjetër greke, dhe nga pak edhe gjuhën kroate-serbe. Ishte



nxënëse e At' Gjergj Fishtës.

Ishte e armatosur me ide kombëtare, e përcaktuar për bashkimin e trojeve shqiptare. Ishte vajzë shqiptare plotë moral kombëtar dhe që njihje shumë mirë gjeo-

politikën e interesat e fuqive të mëdha.

Nuk pranoj pendimin e PKSHE dhe PKJ që e kërkonin nga kjo, në këmbim të jetës. Mori pjesë aktive në luftë për çlirimin e trojeve shqiptare. Pikërisht në luftën e dytë botërore për çlirimin e Kosovës nga okupimi serb. Ishte vizionarja që shihte shpëtimin e kombit në unitetin e tij. Andaj kontributi i saj arriti më në fund që të pajtojë Komandantët shqiptarë, që i ndante ideologjia Shaban Polluzhën dhe Mehmet Gradicën dhe çetat tjera shqiptare.

Deklarata e sajë para panelit kriminel të gjyqit në Prizren, që ishte i përberë nga Ali Shukria vegël serbe dhe të tjerët ishin serb dhe një rus. Marie Shllaku nuk u lig asnjë herë as në këtë gjyq. Ajo më guxim dhe krenari, u tha: “syri nuk me trembet nga plumbi i juaj, aspak nuk i frikohem vdekjes. Po, merrem më politikë nëse ju e quani politikë të drejtën e shqiptarëve për të jetuar në një shtet. Kosovë, gjaku im tu beftë dritë! Rrënoftë Shqipëria. Herët apo vonë bashkimi i trojeve tona do të behët”.

Sot në Pejë u kthye Maria jonë, me at buzëqeshjen që motivon, trimëron dhe edukon vajzat shqiptare.

Kjo tregon se ky komb është fisnik, që lind rrit dhe edukon vajza dhe djem që mbrojnë identitetin e tyre, mbrojnë gjuhën dhe kulturën e tyre, që është civilizuese dhe e rëndësishme edhe për botën e civilizuar sot.

Mark Gjeka



Në goftë se amazonat e vërteta kanë jetuar tek ndonjë popull në histori, ato kanë jetuar në malet tona

FJALA E PLOTË E PRELE MILANIT

1-A nuk ishin amazona VASHAT E KRUIJES, që u flijuan duke thënë: "O ditë të lume të rinisë sonë lamtumirë! Sot po fluturojmë nga ky shkëmb, që nesër do marrim emrin tonë!... Fluturimi i tyre aguese vegoi e ndriti yjet me idealin më të lartë femërorë të amazonave shqiptare!

2- A nuk ishin amazonë NANA E DELISË?! "Vëllezër, miq e shoqni, ma bani hallall! Keni kja me lot e gjame sa keni trishtue malet?! Unë nuk paskam lindë djalë, ai nuk meriton as gjame as kangë. Nuk asht djalë ai që ikë e le shokët në luftë. Deli Shala ku i ke lanë shokë?! Deli marrja ku e ke besën që ke lidhë me vdekë bashkë? Duhej të kishe luftue e vdekë bashkë me ta!"

Në fakt Delia kishte luftue si trimat, por kish ardhë me tregua dhe u nis prapë.

3- A nuk ishin amazonë SHQIPONJA e LEKËS?!

Ne Dukagjinat e çoj pasha në litarë se, nuk tregoi shokët. Pas torturash të randa pa dobi,

Valiu ndërroi takt, urdhëroj të thërrasin nanën e tij. Le ta shohë ajo e shkretë se, çfarë mundimesh po hiqte djali saj. Jam i bindur se ka me i plasë zemra dhe me lot kuje lutëse, ka me ju përbetua të birit:

-Kallëzo birë! Pash dashninë time trego.

Lekë, he biri lokes! Mos u ligështoj! Gjithkush ka le do vdesin një ditë! Biro jepu fund vuajtjeve mizore dhe vdiq si ka hije trimave! Mos të dhimbet gjaku rinore që po të derdh sot me nderë!

4- A nuk ishin amazonë BESË E AMAZONË SHQIPTARE Raze Terakja?!

Me ngatërresë e sipër te stanet në bjeshke një shaljane vret një vendas. Kundër vrasësit turret gjithë fshati, ndërkohë ai shkon e hyn në kullën e Raze Terakes.

Hape derën e nxjerre jashtë atë njeri ka qitë pushkë e asht në gjak me tanë fisin i thirren ndjekësit e gjakësit

- Gjakun lypeni një ditë tjetër. Sot asht në besën time.

-Hape derën, more të thafshin krahët e nxirre jashtë gjakësin e djalit tand! -

"Paçim Zotin se, miku asht ma i madh se djali!"

Razë Terakja, triumfoi utopisht mbi dhimbjen e thellë të një nënë zemërplatur nga vdekja e djalit të saj të vetëm.

Ajo u shndërrua në ikonë e kultit të fjalës së nderit. Kult, që thirret besa e shqiptare, e cila është fjala më e njohur në fjalorin e gjuhës sonë të vjetër.

A NUK ËSHTË AMAZONË MARIE SHLLAKU?!

Luftëtare sy patrembur kundër komunizmit sllav. Mori pjesë në kuvende e besëlidhje burrash në Drenicë, Dobërdol,

Pejë Gjakovë, luftoi në Drenicë, Kotorre Strugë në kohën e një fanatizmi të erret mesjetare, Çika e Dukagjinit e plagosur e tradhtuan, duke rënë në duart e armiqve të betuar të sajë, duke provuar tortura të egra shtazore, të cilat i përballoi me një



qëndrueshmëri të pa shoqe.

Qysh kur je marrë me politikë e pyeti Prokurori i gjyqit famëkeq?

-Ajo iu përgjigj më zgjuars: -Po qysh herët, në moshën 20 vjeçare, nëse mund të quhet politikë dashuria për atdheun.

- A je për Shqipërinë e Enver Hoxhës? -Ne duam që Kosova të bashkohet me Shqipërinë. Unë nuk jam për Shqipërinë e Enver Hoxhës.

-Pse keni luftua kundër partizanëve? -Me ju rrezua ju nga pushteti.

- Cila ka qenë propaganda juaj në popull?

-Kemi kërkua bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, me një Shqipëri të ardhme e jo të sotmen.

-Çfarë Shqipërie do ishte ajo - Një Shqipërinë krye të cilës duhej të ishte Noli.

-Ke bashkëpunuar me gjermanët?

- Unë nuk dua kurrfarë pushtuesi në trojet tona. Isha dhe jam për Shqipërinë Etnike, Kosova dhe Çamëria i takojnë Shqipërisë.

-Pse ke qenë kundër LNÇ?

-Në fillim e kam përkrahë. Por kur pashë të mbanin kapelën me yllin e kuq e drapër e çekan, u bëra kundërshtar e vendosur.

-Çfarë do të bëje me ne sikur ju të kishit fitua?

-Kisha me iu gri si duhanin në çark! Në fund prokurori i drejtohet:

- A din se për këto krime veç plumbi të pret?

Nuk më trembet syri. Jam krenare që i shërbeva Kosovës martire, për aq sa munda. E për këtë rinia e kësaj toke lule ka me sjellë mbi varrin tim.

e mprehtë e sjellshme, shumë guximtare, shkurt fjala, një heroine e pa zëvendësueshme, Bije Dukagjini, motër e Bernadin Palajt dhe e Martin Camaj, dhe vajza e dajës e shkrimtarit të mirënjohur të satirës dhe humorit shqiptarë të ndjerit Paulin Selimi.

Është e lavdishme të jetosh për një ideal! Është rende më e lavdishme të jetosh e të vdesësh për një ideal siç jetoj dhe u flijua Marie Shllaku, për idealin e pastër të Shqipërisë Etnike!

Për mua nuk kanë fare rëndësi as bindjet e saja politike, as rruga utopike për arritjen e këtij ideali, as zgjedhja humbëse e kampit politik, në të cilin aderohet për hir të cilit mori dënimin kapital nga kundërshtarët e saj antagonist. Duhet të mësohem t'i analizojmë gjerat në raport me Kohën, në të cilën janë zhvilluar. Ndasheshin dy ideologji të kundërta armike, ku secila palë kishte zgjedhë si instrument mjetin e forcës, shkopin magjik, që ka përcaktuar fatet e historisë në të gjitha kohërat. "Po të kishim fituar ne do tu grinin si duhanin!"

Marie Shllaku, ishte legjendë e qendrës me temperament heroik, idealiste deri në vetëflijim. Një nga kujtimet i çmuar do të mbetet për mua, është një fotografi e Marie Shllakut, që ma dhuroi Shefqet Këlmendi, ky patriot fisnik gjakovar, i cili shkruante: "Zotit Prelë Milani, dukagjinatit të nderuar, vëllait të heroinës së pa vdekshme Marie Shllaku!"

Botimi i monografisë "Heroina Marie Shllaku" i autorit Shefqet Këlmendi, luftëtarë i mirë i sprovuar i lirisë munguar. Gjithashtu emërtesa e një shkolle të mesme me emrin e saj, mos gabofsha edhe një lagje, madje edhe një titulli artistik për krijuesit letrarë dhe aq më tepër inaugurimi i bustit të saj janë një varg kontributesh me vlera patriotike kulturore e patriotike, për tu marrë shembull sa mirë i vlerësoni ju martirët e kombit, ndërkohë kur ne, në anën tjetër të kufirit here rrëzojmë e here ngremë memorialë sipas masonëve politike.

Në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" ju përgëzoj për punën e bërë dhe ju falënderojmë!

Lavdi jetës dhe veprës së morinës Marie Shllaku!

Faleminderit për vëmendjen!

Shënim: Mundësoj financiarisht për përgjigjet e marrjen pjesë në këtë vepërimitari, anëtar i kryesisë së SHAD, z. Kole Sukullari, të cilën e falënderojmë për zëmërisht.

Prëgatiti për botim
MARK GJEKA,
2 prill 2024, në Pejë

Zëri i vëllazërisë bashkoi këngëtarë, valltarë, veprimtarë e artistë nga trojet etnike

Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" ka vijuar të organizojë edhe këtë vit Manifestimin tradicional "Zëri i Vëllazërisë-2024". Kësaj radhe kjo veprimtari kulturore u organizua në mbështetje e në bashkëorganizim me komunën e Istogut, duke bërë bashkë këngëtarë, valltarë, veprimtarë e artistë nga Shkodra, Postriba, Tuzi dhe nga qytete të Dukagjinit të Kosovës.

Ky Manifestim mbahet në çdo muaj prill, për të lartësuar kujtimin për dëshmorin e kombit, Heroin e Popullit Dedë Gjon Luli dhe malësorët trima, që më 6 prill 1911 ngritën flamurin kombëtar në Malësi, së bashku me luftëtarët dukagjinas me në krye Mehmet Shpendin-Nderi I Kombit.

Ky manifestim u organizua kësaj radhe pikërisht më 12 prill te Memoriali i dëshmorëve në fshatin Vrellë, për të nderuar dëshmorët e kombit nga komuna e Istogut, të cilët ranë më 12 prill 1999, për të mos vdekur kurrë.

Manifestimi është hapur me fjalë përkujtuese nga nënkryetari i Istogut Ali Nimanaj, nga përfaqësuesit e Shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe nga përfaqësues të trojeve etnike Faz Shabani dhe Marash Dedëvukaj.

"Të nderuar pjesëmarrës të këtij Manifestimi përkujtues kam nderin që në emër të kryetarit të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", zotëriut Ukshin Jashari dhe gjithë veprimtarëve të kësaj Shoqate të falënderoj përzemërsisht kryetarin e Istogut z. Ferati, drejtoreshën e kulturës zonjën Vuthaj dhe veprimtarët e kulturës, që na nderuan me gatishmërinë për të vijuar bashkëpunimin e për t'i dhënë forcë e jetë Manifestimit tonë "Zëri i Vëllazërisë", e cila veprimtari organizohet në çdo muaj prill, për të lartësuar kujtimin për atdhetarin Dedë Gjon Lulin e malësorët trima që ngritën flamurin kombëtar në Malësi më 6 prill 1911 dhe për gjithë dëshmorët e kombit që ranë në fushat e betejave për liri për të mos vdekur kurrë", ka thënë në vijim të kësaj veprimtarie, moderatorja Leonora Lokaj për të vijuar me prezantimin e pjesëmarrësve në program.

Pas kësaj këngëtar i njohur Ismet Dema bashkë me grupin e valltarëve kanë nisur me programin artistik, që ka vijuar me këngën për Mehmet Shpendin, interpretuar nga këngëtarja Fatmir Berisha. Ishte ky moment i veçantë, që është ndërlidhur bukur me vijimin e kësaj veprimtarie, kur kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", z. Ndue Sanaj, ka përshëndetur manifestimin dhe ka ndarë titull nderi, me emrin e dëshmorit Mehmet Shpendi, "Mirënjohja Mehmet Shpendi", për nëntë dëshmorët e komunës së Istogut që ranë në betejat e lavdishme më 12 prill 1999: Isemt Bicaj, Skënder Maraj, Abedin Derwishaj, Xhafer Haskaj, Xhafer Mmehmetaj, Bujar Visoqi, Nezir Mujaj, Smajl Fetahaj dhe Izet Shatri, me motivacion: "Për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, vetëflijimin e jashtëzakonshëm në

luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin e trojeve shqiptare dhe mbeten të pavdekshëm në altarin e Lirisë"

Gjithashtu u nderua dhe komuna e Istogut me emblemën e Shoqatës Atdhetare

"Dukagjini", me motivacion: "Për kontributin e dhanë në forcimin e lidhjeve në mesë trojeve etnike"

Manifestimi në Vrellë ka vijuar pastaj me prezantimet artistike nga Ansambli

"Postriba", me këngë e valle, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", Ansambli "Drenica" nga Skenderaj dhe këngëtarë e artistë nga trojet etnike. që janë pritur me duartrokitje nga pjesëmarrësit e



Molla e Shoshit si Kruja e Kastrotit ...

- AMANETI I MARK Mhillit SOT BERI
QË AI TË PREHET I QETË NË MOLLË TË SHOSHIT -

Me datën 19 prill 2024, Molla e SHoshit kishte një ditë të veçantë, se Ajo mbledhi banoret e vet dhe shpalosi një pjesë të historisë së saj të lavdishme nëpërmes birit të vet, Mark Mhill Fushazi në një ceremoni mortore me rastin e rivarrimit të eshtrave të atdhetarit të pashoq, patriotit guximtar, qendrestari të pathyeshëm, luftëtarit pa kompromis, demokratit të paepur dhe besimtarit të kulluar, Mark Mhilli, i organizuar e drejtuar nga At' Anton Kodrari.

I gjithë Shoshi kishte ditë të veçantë, sepse krenohet me këtë burrë!

Kishin ardhur nga gjitha fiset e Dukagjinit, burra të nderuar në këtë ceremoni edhe nga viset jashtë atdheut dhe emigracioni.

Kush ishte Mark Mhilli?

Mark Mhilli lindi në fshatin Mollë, të krahinës së Shoshit, me datën 1 dhjetor 1899, në një familje me emën.

Mori pjesë në tre rrethime, që ju bënë fshatit të Mollës, në gjysmën e parë të shekullit të XX. Rrethimi i parë në gushtin e vitit 1915, kur forcat malazeze sulmuan Dukagjinin. Atëherë Ai ishte i ri, por qëndresa e tij dhe e mollçorve ishte heroike;

Rrethimi i dytë ishte e vitit 1927 nga qeverisja e Zogut si hakmarrje ndaj kryengritjes së Dukagjinit te ura e Mesit, në muajin nëntor 1926, për të kap pjesëmarrësit e kësaj kryengritje;

Rrethimi i tretë ishte në vitin 1946 nga forcat e sigurimit të pushtetit të ri, për të burgos kundërshtarët politik.

Në te tre këto rrethime mori pjesë Mark Mhilli, që pjesëmarrja e tij, në rrethimin e tretë i kushtoj shumë, sepse u arrestua dhe u torturua në mënyrën ma çnjerëzore nga punonjësit e rrëgjimit, por Marku nuk u dorëzua, nuk pranoi asgjë dhe me një dekret të kohës përfitoj lirinë. Pasi u kthye në Mollë vendosi të largohej nga vendi, me disa shok të vet.

Largimi dhe jeta e tij në emigracion ishte mjaft e vështirë, por shumë e lavdishme. Ai, pas shumë vështirësish u vendos në Belgjik, që këtu ndihmoi shumë emigrant shqiptar në emigrim pa dallim përkatëseje.

Marku vdiq papritur me 21 maj 1977 dhe u varros në Bruksel pas një përcjellje madhështore nga Dukagjinasi atdhetare, por e veçanta e kësaj ceremonie ishte pjesëmarrja e Kryeipshvit të Brukselit në këtë ceremoni mortore, dhe duke i predikua meshën e dritës. Por, Marku kishte pas gjithmonë një merak, që e kushte biseduar me shokët, pa e ditur se do vdiste para kohe, se një ditë do të kthehemi në atdhe, sepse si në vendin tanë askund nuk të pushon trupi. Ndaj, me ardhjen e demokracisë dhe lëvizjes së lirë u mundësua edhe kthimi i eshtrave të tij në vendlindje.

Sot, të afërmit tij, nipat Rrok Tome Fushazi me vilazën e kushërinj krenohen me Mark Mhillin dhe e çuan amanetin e tij në vend, duke organizua një ceremoni prefektë, me të gjitha kërkesat e saj.

Merita, së pari i takon vëllezërve Rrok e Zef Tomes, dhe kushëritit të tyre, Dede



Gjonit, por edhe gjithë banoreve te fshatit Mollë.

Por, në veçanti një merite e veçantë i takon edhe At' Anton Kodrarit, djalit nga Molla, që shërben si misionar në Itali, që organizoi e drejtoj këtë ceremoni me shumë profesionalizem.

Shoshi dhe Dukagjini e nderuan birin e vet me shumë rrespekt.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini", percolli vlersimin e saj neprmes fjales mortore, kurores prane arkivolit dhe dhenien e itullit "Anetar Nderi i Shoqates Atdhetare Dukagjini", pas vdekjes, me vendim nr. 282, date 15 prill 2024, me motivacion: "Për kontributin e dhanë për mbrojtjen e trojeve kombëtare, për mbështetjen e mërgatës shqiptare pa dallime feje, ideje e krahine dhe për dashurinë e madhe për

vendlindjen"

Pas ceremonisë mortore të Mark Mhillit, në hapësirën e bar-restorant "FLOGA" u hëngër dreka mortore dhe pas saj, eshtrat e tij u përcollën për në varrezat e fshatit të Mollës.

Lavdi për jetë Mark Mhillit të Mollës!

Shënim: Mundësoj financiarisht për këtë ceremoni mortore, anëtar i kryesisë, z. Kolë Sukullari, të cilin e falënderojmë për zemërsisht!

GJON KOSTERI
Prill 2024

MARK MËHILLI I PRIU DEMOKRACISË 30 VJET DHE ERDHI 30 VJET PAS SAJ!

E nderuara familja Fushazi (Rrok e Zef Toma dhe Dede Gjon Fushazi)!

Të nderuar pjesëmarrës!

Jemi mbledhur për të vendosur përfundimisht në tokën amë, eshtrat e një prej atdhetareve të fshatit Mollë, të krahinës së Shoshit, të Mark Mhillit!

Kush ishte Mark Mhilli?

-Një burrë atdhedashës, pas 44 vitesh në amshim po vjen të prehet në tokën e të parëve.

Ta presim!

- Një veprimtar i devotshëm i mërgatës shqiptare në Belgjikë, vdiq me mall të zhuritur për Shqipërinë, ndaj nuk u preh i qetë në dhe të huaj.

Ta nderojmë sot!

- Një demokrat i papërkulur ishte ndaj ta vlerësojmë!

Prej 78 vjetëve Kodra e Mollës e dëshiroj fytyrën e tij të qeshur, shpirtin e tij bujarë, fjalën ëmbël, guximin dhe trimërinë e pa epur. Prej 78 vjetëve tatat e moçëm, loket fisnike e bashkëmohatarët, që i deshti dhe e deshtën fort, i ka marrë malli për ty. Shokët tuaj shkuan me mall në atë jetë, fort të pritën more burrë!

Mark Mehilli e mbajti fjalën!

Ai sot mbërriti, prandaj një armate e madhe e "gëzuar" e pret me urimin; - Mirë se erdhe Mark Mehilli në djepin ku lindi!

Mark Mehilli lindi në Mollë me 1 dhjetor 1899, në atë bjeshkë të lartë fotozhenike, e cila qëndron si akropol mbi lumin e Lesniqes në pjesën Jug-Lindje të Shoshit. U edukua në akademinë e maleve sipas kodeve dhe virtyteve më të çmuara të traditës. I Gjatë i pashëm, bujarë gaztorë si gjeneratat Mollës nder vite.

Ishte i ri kur fiksoi në kujtesë për gjithë jetën "Rrethimin malazet të Mollës gjatë viteve të Luftës së Pare Botërore, ku mbeten të vrare Shytan Staka, Drande Noshaj shtatzënë, Ndoc Marku e Pjeter Ndou Berisha, që gjendeshin miq në Mollë, dhe u plagosën Zef Staka, Sose Dedja dhe Prekë Ndou, ndërkohë, që të shumë të kërkuarit Dedë Ndou, Ukë Staka, Mark Ndou, Zef Marku e Lulash Staka morën arratinë, duke ia kthyer kusurin dy fish forcave të Mel Spacit, në Gurin e Kuq vetëm pak muaj më pas.

Mark Mehilli, me 1924 përkrahu Opozitën e Nolit dhe Gurakuqit, dhe mori pjesë aktivisht në kryengritjen antizogiste të Dukagjinit në nëntorin e vitit 1926.

Me 1927 ishte dëshmitari i rrethimit të dytë të Mollës nga forcat Zogiste, për kapjen e kaçakut antiqeveritare, Gjon Marashi, i cili strehohej në shtëpinë e vëllezërve Gjeloš e Mark Vata, kushëri të Mark Mhillit. Gjon Marashi me ndihmën e vendasve doli prej rrethimit i plagosur në shpatull dhe në nofull. Gjatë kalimit të Ushtrisë Jugosllave, në territorin e Dukagjinit, në prill të vitit 1941 u pozicionua në Qafe të Agrit së bashku me vullnetare të Mollës dhe Brashtës, duke reaguuar ndaj pararojës jugosllave. Gjatë shkëmbimit të dendur të zjarrit mbeti i plagosur Pal Mirashi, të cilin Mark Mehilli e mori në shpinë dhe e solli deri në Rreth të Brashtës. Pal Mirashi vdiq, po atë

ditë dhe është fatosi i pare Shoshianë në vargun e kësaj lufte të përgjakshme. Gjatë Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare qëndroi indiferent, por familja dhe nipi i tij Gjon Kaceli, ishin simpatizant dhe aktivist të kësaj lëvizjeje. Në verë të vitit 1943 mori pjesë në luftën e Zeletinës. (Bjeshkët e Gucisë), të njëjtën gjë bëri edhe në dimrin e viteve 1943-1944. Në vitin 1946 Mark Mehilli dhe krejt Molla për shtëpi strehuan Deli Marshin, Lulash Gjelošin, Kolë Ndoun, Gjergj Vatën, Konto



Marshin, Mark Malën dhe Bekë Deline, të cilët ishin kundërshtarë të armatosur të pushteti të ri. Molla rrethohet befasisht për të tretën here si Kruja dikur motit. U vra Kolë Deda, në ketë përpjekje, u pushkatua pa gjyq Zog Mala, iu dogj shtëpia e Kryeplakut Pjeter Koca, ndërsa Mark Mehilli u arrestua së bashku me Ndue Kolën, Zef Markun, Zog Malen, Mhill Kolën e Ndue Bibën se, kishin mbrojtur kaçakët më të zëshëm të Dukagjinit nëpër shpellat e koniqet e Mollës, duke shfaqë haptazi urrejtjen për sistemin e ri, që po instalohet me forcë.

Në burgun e Kodër Shëngjergjit provoi të gjitha llojet e torturave që njihnin gardianet e kësaj hapsane të tmerrshme.

Mark Mehilli nuk bëri ëh as oh, as nuk e çili zërin e gojës për të treguar vendstrehimin e koçakve dhe kush mban arme pa leje.

Mark Mehilli u kthye në Mollë me dhembë të shkukur dhe brinjë të thyera e të djegura nga vezët e ziera. "Pasha Krishtin në shkëmb të Gurrës së Mollës hidhem e në duar të tyre nuk bije i gjallë", Marku u pat thënë nipave, Tomë e Gjon Kacelit. Ky mundim i tmerrshëm e nxiti ende më tepër, që të mos nënshetrohej, prandaj doli malit dhe bëri jetën e vështirë të kaçakut. I ndjekur rreptësisht prej sigurimit të shtetit arratiset së bashku me Pashko Pjetrushin dhe Mirash Nduen e Thethit në Jugosllavi. Sapo shkeli në tokën Jugosllave arrestohet nga

UDB-ja, dhe bëri një vit burg, më pas arratiset edhe prej Jugosllavie dhe kërkoi strehim politik në shtetin Italian. Pas pak zuri vend në France, në të cilin qëndroi për disa vjet, u rikthye në Itali dhe mori nënshpëtimin italianë, ndërsa nga fillimi i vitit 1954 shkoi në Belgjikë.

Marku, në emigracion së bashku me Padër Daniel Gjecaj, At Ambroz Martini, Dede Pjeter Volaj ishte nder themeluesit kryesor të "Komuniteti i Diasporës jashtë Atdheut për Çlirimin e Shqipërisë". Ndër miqtë më të ngushtë të Mark Mhillit ishin, At Daniel Gjecaj, At' Ambroz Martini, Gjeloš Ukshini e Pashko Pjetrushin prej Thethit; Ndue Mirash Ulajn, Marash Balën, Mirash Ndoun e Pjeter Kushin prej Prekalit; Martin Camaj e Dede Volaj prej Dushmanit, Mons Dejardin prej Belgjike, Bub Matoshin e Gjon Balën prej Selce, Lazer Pali prej Sume.

Marku gjithnjë beqar fort i pashëm, tejet i ujdísur e i veshur me shije bëri një jetë aktive si veprimtarë i zellshëm i mërgatës shqiptare në Belgjikë. I pa lodhur nga pleqëria, që dukej ende larg, në mënyrë të pa pritësi ndërroi jetë në Belgjikë me datën 21 maj 1977.

Dukagjinasi, që ndodheshin në Bruksel mikun e dashur, të besës, të burrnisë e besimit për në botën tjetër e përcollën me gjame burrnore Dukagjini.

Ipeshkvia e Brukselit ftoi besimtarët në një meshë të posaçme ku thuhej: "Me ndjesitë ma të thella të falënderimit e të mirënjohjes për shka ju Mark keni ba për SHQYPTARËT, në Belgjikë – e sidomos me Pepsujat, - ju grishim të merrni pjesë në meshën e dritës, në kishën ST. SERVAIS, të hanen n' orën 11. 00. Gjithashtu në drekë, fill mbas varrimit; e cila shtrohet në ketë adresë: 13 Rof Henri Berge, Bruxelles (Ky ishte njoftimi mortore për varrimin e Mark Mhillit. Dokumenti autentik, i publikuar për herë të parë nga Anton Kodrari, gazeta "Dukagjini", Nr 81, gusht 2010)

Pater Ambroz Martini lexoi publikisht, në varret e Brukselit një elegji në harmoni të plotë me ritmet e Zemrës së mbushur në vajë për mikun e tij të shtrenjtë.

Trimi qendrestarë, Mark Mhilli, ishte njeri që shihte larg, burrë që nuk pati frikë nga diktatura as nga përparimi. Mark Mhillin nuk e ç' burrëruan as torturat mizore, as lira e pa kufi, as paraja, as interesat e huaja antishqiptare të çdo ngjyre.

Mark Mhilli u sprovua në farkën e qëndresave, sakrificave dhe ëndrrave të vrara. Ky njeri ka një gjysmë shekulli që nuk është më. Ky njeri la pas emrin e mirë që kujtohet me respekt.

Mark Mhilli një shembull i veprimtarit 30 vjeçare që vdiq zemër lënduar larg atdheut të privuar nga liritë themelore të njeriut.

Mark Mhilli i priu demokracisë 30 vjet dhe erdhi 30 vjet pas saj! Kështu do ta kujtojmë dhe nderojmë!

Ju, familjaret e familjes së Mark Mhillit, kjo shi me jete dhe ta kujtoni njeriun tuaj të dashur!

I përjetshëm kujtimi i Mark Mhillit!

POEZI ELEGJIKE

E AT AMBROZ MARTINIT
PËR MARK MËHILLIN

*Le të kjanë mbi varr ledina
Butë i kjosin moti e stina
ak' lli bora e serotina
E prej Zotit kjoftë këne thanë
Na këtu shumë Mark mos me të lanë
Por me bajtë me çue në atë anë
Në ato male titanike
ku banon raca fisnike
që përban Shqipërinë Etnike
Për mbi krye me t' valvitë
Në varr të fisit Mark një ditë
Bash në atë tokë ku je rritë
Kuq e zi flamuri të parëve
Që për herë në tokë të shqiptarëve
Ka nderue deken e të parëve
Dukagjini ka me të kja,
E mbarë Shoshi, që t' pat vëlla
Kush t'ka njoftë, e kush t'ka pa.
Për njet "Besë", që kurrë nuk preve
Për trimni, që sa herë kreve
Ka me xanë Rrac'e Shqyptarit,
Si s'koritet trolli t'parit
As po ra n'dor'n e barbarit.
N'shëmbull t'and, Mark, kanë me msue
Pares s'huaj mos me i lakmue,
N'mulli t'huaj ujë mos me çue.
Prandej Mark, kjo deka jote,
Larg Atdheut tridhetë motmote,
Kurrsesi s'ka me shkue kote.
Njatë qindresë, që ke trgue
Kurrë Shqyptar't s'kanë m'e harrue
E dijnë të gjith se n'dhe t'gerbetit,
S'i shërbeve kurrnji shtetit
Si kanë ba një farë "miletit"...!
Pate ndrý n'zëmren çelike
Njat' burrni t'rracës fisnike
Për me ruajtë Shqyptinë Etnike.
Amanet mos me u mërzitë.
Për njatë kohë, që ke me pritë
Me t'çue n'vëdin, kù je rritë.
Oh sa hall, oh vaj medet!
Me pritë njeri n'nji vorr shkret
Ban Gajret si bane motit
Si dikur me ndihme te zotit
Kthej nder troje të Kastriotit
Në varre të fisit je ma mirë
Si gjithmonë pate dishirë.....
Kurë t'a bajmë Shqyptinë e lirë.
Atje n'Mollë ke me pushue
Ku je le, e je burrnue
Bjeshkët e Mollës të bajnë kunorë
brez pas brezi për çdo korë
Si në pranverë si kur bjen borë
Shumë e motra tash bërtet
tuj vajtue mbi vëllaznit të vet
Për ty dekun në Kurbet
Por kurë të çojmë, Marka, n'Shqyptni
E ndienë vedin si n'rini:
Nën Flamurin Kuq e Zi.
Kurr një grimë mos bajë idhnim,
Se ksaj toke, të lamë dorëzim
Dersa t'vinë dita për kthim.*

Dhe njëherë, në emër të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", ju familjare të Markut ju shprehim ngushëllime dhe të jeni jete gjate e ta kujtoni njeriun tuaj të dashur!

PRELE MILANI

Shkodër, me 19 prill 2024

Të jesh punonjës i shtetit do të thotë të veprosh dhe të përgjigjesh shtetërisht qytetarve



Fran Gjoka

Realiteti shqiptar paraqitet tepër konfliktual i krijuar tashmë edhe brenda shoqërisë së sotme. Jetojmë në një kohë tepër intensive, ku nuk ka më kohë njeri të dëgjojë lloj-lloj fjalësh të bukura apo versione demagogjike të panevojshme nëpër mitingje apo në kolltuqet e stacioneve televizive, por të ngrejme zërin e pandërprerë për të gjitha problemet që shqetësojnë shoqërinë e sotme shqiptare si papunësia, çmimet e larta në raport të zhdrejtë me pagat e pensionet, të shoqëruar me varfërinë e thellë të familjeve shqiptare, mungesa e ujit e dritave, ambjentet sociale tepër të ndotura, shumë linja të energjisë elektrike të amortizuara dhe rrugë në fshatra të shkatërruara e të tjera. Këto pasoja vijnë nga mungesat e politikave ekonomike shtetërore sidomos për të rinjtë, pra janë

çështje permanente dhe që kërkohet të preukopojë çdo pushtetarë të zgjidhur me votën e lire të popullit. Kur bisedon me punonjës të administrates vendore kop-ton se nuk ka asnjë strategji afat shkurtër apo afat mesëm në zbutjen sadopak të varfërisë, por mbretëron gjithçka e përgjithshme në objektiva, asgjë e përcaktuar qartë për premtimet e bëra. Pra, me një mungesë cinike të transparencës. Këtu më vjen ndërmend një thënie e Xhorxh Sorasit i cili thekson: "Ka dy lloj mbijetesash, është ajo e atyre që mezi sigurojnë jetën, por edhe atyre që kanë shumë pasuri".

Edhe pse kemi kaluar më shumë se 33 vjet në tranzicion, shteti ynë vazhdon të qëndrojë ndër vendet më të varfëra në Europë, me nivel të lartë kriminaliteti, ku O.B e shëndetësisë e rendit Shqipërinë në vendin e tretë në botë për vetëvrasje, për shkaqe ekonomike, me të papunë të shumtë, rritje galopante të çmimeve, me paga qesharake të buxhetorëve, thellim i deficietit tregtar buxhetor në vend të shoqëruar këto me investime tepër të ngadalta dhe mjaft të ulëta e të tjera. Kemi fshatin, që ende prodhon emigracion, punë të zezë, pa asnjë mbështetje e siguri shtetërore për të ardhmen. Në qytetet tona shoh punëtorë që qëndrojnë shesheve për punë nga mëngjesi deri në mbrëmje vonë. Janë me qindra krahë të lire pune që kthehen darkave në shtëpitë e tyre pa asnjë qindarka të fituar për të siguruar bukën

e gojës. Ky është rrugëtimi i përditshëm i tyre nga fshati për të garantuar një ditë pune në qytet. Ndaj bashkitë kërkohet të ndërtojnë dhe menaxhojnë me efektivitet strategji me afat shkurtër dhe të mesëm punësimi të punëtorëve sezonalë për krahun e lire të punës brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mënyrë që të ndihmojë sadopak në zbutjen e varfërisë në qytet dhe në fshat.

Aktualisht, kemi të bëjmë me një kontigjent të dëshpëruarish, që askush nuk interesohet për ta ndihmuar. Me pak fjalë duhet nënvizuar thekshëm se, tregu i pasurisë makute është tepër mbytësë, ku janë ngritur kulte të rreme të pasanikëve injorantë, ca administrues pa kulture, drejtues profane, rryshfetxhinj dhe bezdisës përpara komunitetit, ndërsa dinjiteti i tyre ka dale në treg dhe shitet e blihet si mall demode. Përballë tyre, njerëzit në nevojë po humbasin të drejtën e lirisë duke thenë se kërkohet ritmikisht ujë dhe drita dhe asgjë më shumë. Dhe harrojnë se sovraniteti i tyre shkon më tej tek pasuritë kombëtare, tek pronat publike, tek kultura kombëtare, tek trashëgimia historike dhe përgjegjësitë ndaj partneritetit institucional ndërkom-bëtar. Shqiptarët e gëzojnë të drejtën të shfaqin vullnetin e mire, se duan të ndryshojnë jetën e tyre. Megjithatë thellimi i reformave në strukturat e shoqërisë mbeten ende një vullnet spontan i pamotivuar dhe shpesh bëhet çuditërisht i nxitur, të përfaqësuar nga ata politikanë e push-

tetarë, që tregohen shpesh inkopetent në planin ekonomik e financiar. Institucionet e shtetit shqiptar, janë aq larg problemeve e halleve të qytetarëve, sa kanë qënë afër tyre organet e antishtetit të dikurshëm socialist, pra strukturat institucionale janë larg të qënurit të standartizuar. Është shansi për të thënë të vërtetën si vend dhe si komb, për t'u ngritur e për t'i thenë "ndal" të keqes që na ka kapluar. Kjo shton zgjuarsinë intelektuale, kurajon qytetar, pjekuri e maturi në gjetjen e rrugëve efektive demokratike e ligjore në mbrojtjen e fjalës së lirë, duke shkarkuar përfundimisht nga supet, barren e rëndë që ka pllakosur shumë familje shqiptare. Shikojmë çdo ditë mosfunksionimin e institucionit të eprorit direkt, në disa njësi administrative publike e vendore, që kanë vendosur një skemë fictive të shërbimit civil në këto njësi vendore. Ka bashki e njësi vendore të fyera, jo funksionale, jo efçente, me shpenzime të tepërta të cilat nuk e justifikojnë detyrën që kryejnë dhe lojën që po luajnë në kurriz të taksapaguesve të sotëm shqiptarë. Në administratë qoftë në nivel qëndror dhe lokal, sot ka mjaft nëpunës që kanë lënë vendet për arsye absurde, po ashtu siç ka mjaft të tjerë që i kanë zënë vendet pa asnjë lloj merite, përveç të qenit militant ose taraf me shefat e fuqishëm shtetërorë. Fatkeqësisht po rritet në mënyrë galopante kultura e bakshishit, që po kalon çdo ditë nga qytetatri hallelxi, tek nëpunësit privatë apo ai shtetëror, por

Manifestimit.

Pjesa e dytë e kësaj veprimtarie tradicionale ka vijuar me këngë e valle në ambientet e bukura të restorantit "Freskia", falë pritjes vëllazërore të kryetarit të Istogut, z. Ilir Ferati dhe institucioneve komunale. Kryetari Ukshin Jashari dhe sekretari i përgjithshëm Frashër Racaj, në emër të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësie e Madhe "Martin Dreshaj" kanë dhanë mirënjohje të veçanta, post mortem për dy kryetarët e ndër të Istogut Fadil Ferati e Haki Rugova, për kontributin e tyre të lartë në shërbim të bashkëpunimit mes trojeve etnike.

Në mbyllje të kësaj veprimtarie, koordinatori për bashkëpunim me trojet etnike ka falënderuar kryetarin, drejtoreshën për kulturë dhe institucionet komunale të Istogut, për bashkëpunimin dhe mbështetjen për Manifestimin.

Ai ka ftuar të pranishmit, që me një minutë heshtje të nderojnë Kapllan Nikçin, që ishte figurë emblemë e Ansambli Autokton "Rugova", që u nda nga ne para tri ditësh. Përfaqësues i këtij Ansambli, duke u shprehur i nderuar për këtë lartësim të kujtimit nga ndarë me pjesëmarrësit momente nga veprimtaritë e përbashkëta me Shoqatën e vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", pjesë e të cilave vijimisht ishte edhe i ndjeri Kapllan.

Z. Jasharaj, në fjalën përmblylëse ka përgëzuar për angazhimet dhe bashkëpunimin kryetarin Ndue Sanaj dhe gjithë



Shoqatën Atdhetare "Dukagjini, Ansamblin nga Postriba, Ansamblin "Selman Kadria" dhe "Drenica", veprimtarin dhe vëllain e dy dëshmorëve të kombit Ali Tahiri, veprimtarët Ismet Demaj, Faton Bytyçi, poeten dhe motrën e dëshmorit të kombit, znj. Kumrie Shala dhe veprimtarë të tjerë, që ndihmuar në rrjedhën e mbarë të kësaj veprimtarie.

Drejtoresha e Kulturës, znj. Vuthaj ka ndarë në emër të komunës së Istogut mirënjohje për pjesëmarrësit e këtij manifestimi përkujtues e artistik.

Shënim: Mundësoj pjesëmarrjen në këtë manifestim, N/kryetari i Këshllit të SHAD, z. Viktor Arrinaj dhe anëtar i SHAD, z. Dash Steri (David Lteri), të cilët i falëndojmë përzemërsisht!

RRAHMAN JASHARAJ

me një etikë të mangët administrative dhe këto dukuri negative po dalin çdo ditë në emisionet televizive si ato të topit apo në fiks fare.

Emerohën në postë kyçe individ të vendosur, njerëz që nuk kanë asnjë kualifikim, apo nuk dinë si drejtohet dhe organizohen punët në administratën vendore. Shikojmë çdo ditë që qytetarët përballen me kompetencën ose agresivitetin e administratorëve. Shikojmë në zyra punonjës që bëjnë punë dhe shërbim të përkryer në zgjidhjen e halleve të qytetarëve, apo të tjerë zyrtarë që i fusin nëpër labirinthe hallexhijtë, duke i mbyllur në rrethe vicioze, nga ku nuk mund të gjejnë mundësi zgjidhje. Dhe pa dyshim një pjesë e mirë e qytetarëve të këtij vendi u ka takuar të gjenden në situatë të vështira, ku kanë mallkuar edhe veten dhe janë lutur që disa administrator, që shikojnë jo hallin, por xhepat duke u quajtur si taksidar dhe jo zyrtar. Të jesh punonjës i shtetit do të thotë të veprësh dhe të përgjigjesh shtetërisht. U

shkatërruan nervash hallexhijtë, duke i kërkuar zyrtarët nëpër lokale apo prituri me ore të tera. Është e nevojshme që këtyre hileqarëve, tu vihet një kufi ndarës ose të zbatohet me rigorizitet disiplinën shtetërorë, ndryshe të dalin jashtë sistemit. Të tillë administrator të papërshtatshëm nuk është se, i takon vetëm në bashkitë dhe njesitë vendore, por edhe në institucionet e arsimit, të shëndetësisë, policisë dhe të prokurorisë dhe gjykatave ky kontigjent nuk leviz për me shume se dy dekada dhe nuk ka forcë që ti zhvendosë për tu lene vendin të rinjve me të shkolluar dhe të kualifikuar. Vazhdojnë të qëndrojnë në këto pozicione, jo për merita dhe njohuri, përvojë dhe kualitete si specialist të fushës përkatëse, por vetëm se shikojnë duke ndërruar teserën e partisë nga një mandate qeverises në tjetren dhe kështu e gjykojnë ata që kanë dore emerimet si deputet, ministër, drejtorë e drejtorive qendrore apo lokale qofshin.

Mirëpo këto të ardhura dytësore dalin nga xhepat e njerëzve në nevojë dhe si pasojë po rëndojnë çdo ditë buxhetin ekonomik të shqiptarëve. Me keqardhje, duhet të pranojmë se administrata aktuale e këtij vendi mbetet më e korruptuar në historinë e shtetit shqiptar, ku zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të cilën unë shpreh zhgënjimin tim si gazetar, kanë kryer veprime të shëmtuara, kanë zhvatur rryshfete kundrejt një shërbimi të paligjshëm, ku me uzurpimin e shumë trojeve e pronave të tjera të palujtshme “të mbetura pa zot”, pasi i kanë hipotekuar i kanë gllabëruar ato në bashkëpunim dhe me disa pushtetarë të korruptuar lokalë. Nëpunësit aktualë kanë vite qëndrimi në një vend punë të palëvizshme, ndërsa shumë prej tyre janë bërë tepër të përfolur dhe etiketuar si rryshfexhinj dhe marifetxhinj të vërtetë. Dhe për këta individë të përfolur heshtin drejtuesit e qarqeve, bashkitë dhe drejtuesit e pushtetit vendor. Nëpunësi në kontakt me qytetarin do kohë që të edukohet dhe këtë edukim të tij e bën ligji i shtetit të së drejtës. Këtu kërkohet urgjentisht reformim të thellë të hier-

arkisë administrative, racinlizim i hallkave të burokracisë, kontrolli i rreptë efektiv dhe vertikal i institucioneve, përdorimi i teknikave administrative të dobishme, kështu mund t’u vihet fre brenda një kohe të shkurtër këtij fenomeni tronditës, por që rrit koston e jetesës së qytetarit për shkak të keqfunksionimit administrative të hallkave të ndryshme të aparatit shtetërorë. Braktisja masive e aktivitetit nga rinia dhe inteligjenca që varion deri në 40% shifër që tregon nivelin e papunësisë masive në vendin tonë, ku vetëm për femrat arrin në 75% shifër kjo marrë nga organet qendrore të shtypit, fshatra të tëra të braktisura nga njerëzit dhe vendosja e tyre në zona urbane me një mbipopullim të rënduar, duke krijuar zona të reja informale dhe probleme për qeverinë aktuale. Ka zona të Shqipërisë me shkollat të dëmtuara, e me fëmijë analfabetë dhe mbi një mijë fëmijë të ngujuar nga fenomeni i gjakmarrjes. Të gjitha këto tregojnë mungesë impenjimi dhe vlerësimi të bashkitë dhe të njesive administrative të vendit.

Gjatë këtyre viteve, thujse askush nuk ka menduar apo mendon të pyesë se çfarë punë të frytshme po bëjmë për këtë vend, por vetëm diskutojmë sa para e prona ka përvetësuar ky apo ai politikan e pushtetar, sa fëmijë ka shkolluar jashtë shtetit, sa ka sistemuar të afërmit e tij e të tjerë, se çfarë detyrimi ka deputeti apo përfaqësuesi i zgjedhur nga populli ndaj këtij vendi, që nesër të mos ndihemi të turpëruar përpara vetes dhe fëmijëve tanë nuk e diskutojmë. Kështu, sot mund të numërojmë arritje individuale, por kurrsesi nuk mund të themi se po bëjmë atë që na duhet për t’iu krenuar brezave. Dhe konkretisht çfarë na afron çdo ditë ne shqiptarëve, përveç lufrave banale, kërkesave absurde në dëm të këtij populli fukara, për t’i mbijetuar mentaliteteve të vjetra, injorancës, boshllëkut shoqëror e të tjera.

Në Shqipëri opinionioni publik duhet të veprojë si sanksion si një ndër të vetmit mjete shtrënguese ndaj këtyre dukurive negative për shoqërinë tonë. Pra, ka ar-

dhur koha që duhet ta kalojmë shoqërinë shqiptare në një shoqëri që zbaton rregullat, në një shoqëri institucionale. Këtu më vjen ndërmend një frazë e akademikut Rexhep Qosja i cili pohon se: “Kur politika shkëputet plotësisht nga morali, atëherë çdo gjë është e mundur...”. Mënyra më e mirë në këtë rast është që shqiptarët të jenë të hapur për njerëz të denjë dhe të pafalshëm për kapadainj që tërë jetën e tyre mbeten pushtetarë të përjetshëm. Dhe ajo që është më fatale, kur kërkon të bisedosh me ta për ndonjë shqetësim çasti nuk të përfillin fare ose perdorin rrugë dredhimi për t’i ndarë nga shqetësimi i qytetarit dhe më e keqja ndërtojnë dhjetëra justifikime të paqena vetëm për të nxjerrë përfitime personale të paligjshme.

Unë besoj tek shumë njerëz të mirë dhe të drejtë që punojnë në administratën publike, janë të ndryshëm nga “të mençurit”, janë kundër intrigave, rrushfetit, janë kundër atyre që nëpërkëmbin çdo ditë parimin e barazisë dhe të drejtësisë. “Njerëzit çmohen nga lartësia e shpirtit, nga gjërësia e mendjes dhe bukuria e pamjes, –ka thënë Gorki. Ai, që shkel ligjin, shkel institucionin dhe padyshim nuk ka një moral të tijin, të vërtetë...”. Mënyra më e mirë është që shqiptarët të jenë të hapur edhe për ata punonjës publik që kërkojnë para në zyrat e shtetit. Këto të fundit arrijnë edhe të përfitojnë edhe nga mungesa e kordinimit të qytetarëve me njëri-tjetrin dhe synimi injorant për t’i kryer sa më shpejt dhe me lehtësi punët.

Të kërkoj sot një të drejtë nuk është e lehtë. Duhet të dish ku, si dhe kur e kërkon atë, dhe për më tepër, në rast se duke qenë në rregull me këto tre gjëra, përsëri nuk arrin tek e drejta, por kjo arrihet vetëm përmes rryshfetit. Provo njëherë të bësh një ankesë zyrtare në strukturat qendrore apo lokale të qytetit apo rrethit, të frenosh ndonjë shfaqje të hapur të korrupsionit. Fatkeqësisht, shkon qytetari për ndonjë ankesë apo nevojë të tij personale, administratorët nuk i presin qytetarët, por gjejnë justifikimin, duke thënë me paturpësi: Bej kërkesë me shkrim dhe ne të kthejmë

përgjigje. Lind pyetja: Ku e kanë marr këtë lloji modeli të turpshëm ndaj qytetarëve të thjeshtë të këtij vendi? Kjo do të ishte rruga më e gjatë, më e lodhshme dhe pse jo ndoshta edhe më e kushtueshmja, por vetëm kjo do të ishte rruga e drejtë ajo që do të bënte në fund të fundit qytetari sepse kështu ai do të ndjehej më mirë me veten. Në administratën qendrore e lokale ka mjaft intelektualë të përkushtuar dhe të ndërgjegjshëm për shqetësimet e komunitetit të tyre, por fatkeqësisht është edhe një kategori tjetër personash të pandërgjegjshëm dhe të përfolur shumë dhe përsëri qëndrojnë në vende pune kyçe në administratën publike dhe bashkësia vijon të flasë në adresë të tyre. Qytetari i vërtetë i këtij vendi nuk duhet të heshtë kur drejtuesit e administratës publike tallen me hallet e këtij populli. Prandaj, duhet t’i themi ndal korrupsionit në administratën publike. Zgjedhësit nuk duhet të mbeten “robër” të politikës, e cila jo rrallë herë ka dhënë shembuj për të keqin, ajo ka ditur ta përdorë intelektin e tyre vetëm në shërbim të politikave të saj. Dëgjojmë njerëz të të gjitha kategorive, që flasin për korrupsion, paaftësi, abuzim dhe asgjë nuk ndryshon për mirë. Në shëndetësinë dhe në drejtësinë tone të sotme ka korrupsion dhe jo rrallë herë ky fenomen shkon deri tek kufijtë e krimin ekonomik dhe financiar, duke zhveshur këtë profesion kaq humanitar nga çdo lloj ndjenje humanizmi, por kurrsesi nuk futen në një thes gjithë personeli mjekësor në shërbim të masës. Në radhët e bluzave të bardha ka me qindra punonjës të ndershëm që janë të detyruar të jetojnë me të ardhurat zyrtare. E shikon se një veprim i kryer i mjekut apo gjyqtarit ndaj qytetarit, ka brenda korrupsion, duhet të përfundojë në kallëzim penal, që kërkon lekë, para se të operojë apo të gjykojë. Këto janë një pjesë të shqetësimeve të përditëshme që për ne janë bërë të zakonshme, por që qeveria dhe shteti shqiptar duhet t’i ketë në qendër të vëmendjes për të ardhmen, por fatkeqësisht kjo e ardhme është tepër e largët për shqiptarët.



Të njohim vlera eko-turistike. NË PARU TË RRJOLLIT.

Ky reportazh është shkruar rreth 89 vite më parë në bjeshkën Rrjollit. Ajo zonë ka qënë një nder vendet në malësi që vizitohet shumë nga grupe të ndryshme kryesisht të rinjë qytetarë shkodranë por dhe të huaj. Reportazhi përshkruan shumë bukur zonën me vlerat e saj natyrore. Disa nga emrat që përmenden në këtë shkrim sot thirrën ndryshe por ata që njohin zonën që përshkruhet dhe zonat që qrkojnë, arrijnë ti saktësojë për cilin zonë, mal apo fshat bëhet fjalë.

Autori pas përshkrimit të qëndrimit për rreth 7 ditë në Paru të Rrjollit, në fund jep një mesazh shumë të rëndësishmëm që sot pas gadi 90 vitesh tingëllon dhe duhet të dëgjohet më shumë se kurrë:

NJIHNI SHQIPËRINË E KËSHTU DO T'A DASHURONI SHUMË KËTË VEND KAQË TË BUKUR DHE GATI HYJNOR.

Jemi kah mbarimi i mojit të Korrikut, kah mjesi i vapës së verës. Kohë e cilla të ban me i sjellë syet kah malet e Mbishkodrës, male kaq tërheqëse e qi si padashtas të shtyejnë me i shijue për s'afërmi.

Kështu grupe Shkodranësh, të rij dhe burra me një rucksack mbas krahësh, dalin dita me ditë, pa ague mire drita, ndër këto bjeshkë të madhnueshme, qi u lanë shëtitësavet të huej një përshtypje të mirë e qi na vendasit nuk i çmojmë pse nuk i njofim sa duhet.

Në mes t'asajë morije malesh, tue fillue prej Cukalit e deri ne Veleçik, qet kryet mbi shoqe si në shej madhnie një majë e naltë. Asht maja e Ndreut, m. 2000, e ves-hun me borë.

Nji gojdhane e moçme thote se në këtë majë rrijshin kulshedrat. Nji burrë i vjetër, emnit Ndre, hypka maje kësajë majës prej kahë nuk u kthye ma. Ç'atëherë e mbrapa kje thirrë maja e Ndreut.

Kah e mbajta kapen si shoqe dora-doras majet e Pshiklit, e Stërbicës, e Papve dhe e Mjekërr-Madhit. Kah e djathta majet e Krinit, e Derrit, e Paruzës, e Mngullës, e Kujthit, e Partyles e majet e Hejzve. Këto maje janë të mbulueme me pishë e kullosje baktish. Për nën këto maje të nalta e të tjerave ma t'ulta, shtrihet një fushë e blert kund 1 km2. Asht fusha e Parunit, naltsija e së cillës mbrin m. 1200 mbi syprin të detit.

Ndër dy anët e kësajë fushe janë të ngrehuna me drasa pishe ksolla malcorësh, t'ardhun nga Rrjollit dhe nga viset e Nënshkodrës, ma me shumicë nga Velipoja. Malcorët kan prue me vedi edhe baktin e fusha e Parunit me rrethet e saja i nep nji kullosje të majme. Kurrnji prej nji bajrakut tjetër s'mund të ngrehëte vendbanim në Paru, përveç Nën-Shkodrakve të cillët e njehin vedi nji fare e fisi me Rrjollësit.

Fusha vetë asht e rrethueme me hala e pisha të nalta. Këtë fushë e shtijnë në mjedis edhe dy tjera me bar të njomë, por ma të vogla. Të ftoftit nuk lejon qi të mbillen të lashta. Nji prue i thatë e dan për mjedis

fushën e cilla dimnit asht nji gropë bore së madhe.

Tash në verë blerimi i fushës, uji i ftofët i krojeve pse i dalun prej bore e vetë bora bri fushe e bajnë Parunit të freskët, prendverë e vijueshme lulzimi e blerimi, natyrë knaqsiye e bindjeje.

Paruni ka shetina shum dhe kura. Në çdo ças syeni të shef pamje madhështore,



Livadhi i pare, Paru - Rrjoll



në çdo ças të paraqitet ka 'i ramë e re tërheqëse.

Edhe na si të rij e dishruesa të vendeve pitoreske, si jane ata të Shkodrës, u mblodhëm grup.

Rrashi, me pak shpija ka nji kishë historike si pyrg. Bri këtij gjinden do vorresa, rrethue me mur.

Mbas nji shikimi të shkurtë u shternguem për nji rrugë të gjatë e të pa pushueshme. Ecëm 1/4 orë nji rrugës zhurinë sa me të humbë kamba, deri qi i hypëm nji kodre së vogël e mbandej vijuem nëpër dredhina te nji malit jo të neltë.

Teshma dielli kishte marrun dhen e

rrezet e tija na ngrofëshin n'at mëngjez të ngritë. Për mbas do maleve t'ulta, pam do shtëpija. Në parë kujtuem se asht Rrjollit, ishin shtëpijat e Lapuroshit, katund i vogël me nji pus në mjedis, kthell m. 30. Ky pus ka pak ujë, por e ka të freskët e të let.

Prej këtej bjerrim naltsi por fitojmë giat. Tue udhtuem për të parën herë në këto ana, shpesh si pa u kujtue, u ndalshim

fushë, që na paraqitet në të tanë madhnin e sajë, fusha e Parunit, nji bukuri natyre.

Na hypem maje nji shkambi. Ishte nji aso ditësh të bukura të thuesh si të prendverës. Dielli kishte çfaqë ftyrën e vet përmbi majet e Stërbicës e të Papve e të maleve për rreth. E gjithnji vijonte tue i zgja rrezet e veta në fushën e gjanë të Parunit, ku hijet e pemve treteshin giatë e giatë përtej tyne.

Të prekun prej kësajë së pamje nji zanit bërtasim prej galdimit: "Të falena Paru mbreti i bjeshkëve të Shqipnis".

Si sheti të parë zgodhem Qafen e lugut të thatë. Gjindet nën majet e Mngullës e të Paruzës. Udhtimi bahet kah e djathtëta e fushës së Parunit. Në këtë anë të qafës gjindet borë me shumicë.

Prej lagshtinës në mjedis të borës asht ba nji zgavërr. Aty pushuem dhe u ftofem me borë. Na u dukte se jemi në dimën. N'atë anë të qafës e përmbi nji kodër të vogël u çfaqëte nji pamje madhështore.

Përpara kishim Shkodrën sa 'i bu-brrecë, Taraboshin e liqenin. Përmbra: Rrshellin, Ndermajmat e majen e Zezë. Poshtë: katundet e Pultit.

Shetija e dytë kje në majen e Ndreut. Pa zbardhë drita u nisëm për atë maje. E tue i ba ball çdo rrezikut qi na vite prej rugave të ngushta e shkambijeve të thepisuna, në mes të frigës e të gëzimit u ndalëm mbi borë para majes se Ndreut. Pushuem e e kapem majen thik.

Shikimin e mbajshim gjithmonë përpara, pse nji shikim i shpejtë mbrapa mund të na kushtojë jetën.

Vall ky shteg aq i vishtir, a mos kje në kohë të moçme kshtjelli mprojtës i malcorve t'onë kundra qetave sulmuese t'anmikut?

Kaluen 7 dit si 7 çasa. Kaluen nëpër shetina e në borë. E në të shtatën ditë, kur u nisme me ardhë u ndite kumbimi i pushkëvet, qi malcorët në shej përshndedjeje s'prajshin tue qitë.

E vijuen gjithnji, deri sa mbrrijtem për mbas nji malit qi dante dy fushat e Parunit.

Filosofi i math german - në se një filosof aq i math sa ai nuk është i gjithë Botës - ka thënë se ne 'mund të duam veçse atë që njohin. Njihni Shqipërinë e kështu do t'a dashuroni shumë këtë vend kaqë të bukur dhe gati hyjnor.

Shenim: Botuar në Revista "Minerva" Gusht-Shtator 1935. Nënshkruar: Tom GJYSHJA

GJYSHJA Tom (Person i dënuar nga regjimi i meparshem, arrestuar dhe burgosur giatë spastrimeve në Shkodër, 1945. AQSH, F.14, V. 1945, D. 215, Fl. 73. Buri-mi:

Përgatiti për botim:

GJON FIERZA, ing. Pyjesh

At Justin Rrota dhe Shkolla e Planit (1917-2017)

Justin Rrota lindi në Shkodër, më 17 shkurt 1889, në një familje me tradita kombëtare e kulturore.

Justini (emri i pagëzimit Ndoc) lindi në Shkodër. Ishte djali i tretë i Gjush Rrotës, një liberaldhësi. Pavarsisht pushimit t'egër osman, i ati i shkolloj të gjithë fëmijët, Kola, u bë profesor në Katedrën e Gjuhës shqipe në Vjenë; i dyti, Simoni, një ndër piktorët më të mëdhej shqiptarë; Justini u bë frat, por jetën ia kushtoi veçanërisht gjuhësisë shqiptare dhe studimit të autorëve të lashtë, arbëreshë e të Shqipërisë amë.

Më 22 gusht 1902 hyni në Kolegjën françeskanë, ku ishte drejtor At' Fishta.

Më 1904 veshi zhgunin e rishtarit për frat në Rubik e që me këtë rast iu dha emri Justin. Mbas një viti kaloi në Troshan, ku studjoi teologji. Po në gusht, tashmë në vitin 1907 në Klagenfurt, Austri për të thelluar studimet në teologji, por kthehet pa e mbushë motin për arsye shëndetësore dhe i kryen studimet në Shkodër nën drejtimin e At' Gjergj Fishtës dhe At' Ambroz Marlaskajt. Shugurohet meshtar më 11 gusht 1914 në Kishën e Fretënve, në Gjuhador; predkun e rastit e mbajti Frati i Madh, At' Gjergj Fishta [1]. Emërohet profesor i gjuhës dhe latinishten po në atë Kolegj, ku kishte rritë shtatin e marre pjekurine edhe ai vetë

Gjatë viteve 1911-1917, Justini shërbeu si profesor i gjuhës shqipe e i besimit ndër klasat qytetnore të shkollave françeskane në Shkodër. Kur filloi botimin gazeta "Posta e Shqipnis", ishte emënuar në redaksinë e kësaj gazete, në detyrën e redaktorit.

Më 1917 fratini e ri e emnua në fshatin Plan të krahinës së Pultit, përcjellun nga e ama dhe At' Fishta. Atje, për herë të parë, ra në kontakt me gurrën e pashtjerrëshme popullore dhe u çudit: Ishte një shqipe si e dalun prej shkambijsh graniti, legjenda e përralla mitike, një kangë që shungulonte malet, e mbi të gjitha atje njohu me themel atë shqiptarin e patjetërsuar. Iu vu punës në njohjen me themel të çdo elementi gjuhësor, të çdo tingulli e të çdo trajte morfologjike, që ndryshonte shumë nga ajo e Shkodrës, ku ishte le e rritë ai. Ndërsa vijonte edhe natën në dritën e kandilit të sendërtonte atë sistem gjuhësor të të folmes së Dukagjinit, që askush para ti nuk e kishte shtjelluar, në mëngjes priste në qelë vogëlushët: pa asnjë mjet e mbështetje, ai hapi shkollën e parë në fshatin Plan e u ba mësues i dukagjinave të vegjël. Shkruan "Posta e Shqipnis", 14 korrik 1917: "Me 11 të këtij mueji u nis në Plan, famullí e di-

oqezit të Pultit, i nderti z. At Justin Rrota OFM, pse, si patme lajmue njëherë në fletore tonë ky vend i kje shenjue prej parijet të Provincës françeskane. Na, tuj e pasë ç'me temelim të fletores, per mbarshtrues t'censhem e bashkëpunëtuer të vlerhtë, i urojm një udhëtim të mbarë, tuj dishrue

që vlerhtësia e njoftun e tij, të dalë edhe ma në shesh ndër mësim, sidomos fetare, por edhe qytetnore e kombëtare, për të cillat ato krahina janë të ngutshme".

Kështu, më 2 dhjetor 1917 shpalli zyrtarisht në kishë hapjen e shkollës së katundit, më 3 dhjetor u regjistruan 24 nxënës. Gazeta "Posta e Shqipnis", shkruen "...Ç'me të parën ditë të dhjetorit ka hy në veprim shkolla shqipe në Plan. Njëzet e katër fëmijë... bashkohen tu Qela e famullitarit... Kujdesin e kësaj veprë tejet bamirëse e qytetnuese e ka fort i nderti e i vlerthi z. P. Justin Rrota OFM, i cili me

qenë të ushqyeme prore prej një atdhedashunije të flakët e vepruese, shkon tuj e prirë kah dija menden e atyne të vogjelve e tuj ia stolisë zemrat me njato ndiesina,



të cillat të bashkueme me mësim i japin shoqnisë gjymtyrë të shëndoshta e të vjefshme e karaktere, që me kohë mund të dalin nder e lumni për atdhe". Në Plan



u kujdes për të kërkue ndihma nga austriakët për malësorët e varfër, mblodhi material të ndryshëm gjuhësor, filloi të shkruajë dhe u mor edhe me falje gjaku, veç shërbesave fetare, pa u shkëputë prej gazetës në fjalë. Do ta vizitojnë eprorë, autoritete austriake, miq, si: Fishta, P.Mark

Harapi, P. Çiril Cani. Me gjithë mungesat e pengesat, vështirësitë e hallet e jetës, P. Justini do të ruejë përgjithmonë nostalgjinë për jetën misionare të Planit. Pak para vdekjes, do të shkruajë: "Sa për veti, unë, edhe pse jam plakë e mbetë, famullín e parë e të mbrame, Planin e dashun, kurr s'harroj. Edhe shpesh, për të hjekun mallin e atij misjonit të vogël, i lexoj me nostalgji shënjimet e ditarit të atëhershëm. Aty mbrendë e kujtoj njëkohësisht edhe P. Mark Harapin, i cili më është gjetë fort, posaçe ato ditt e para të famullís së re..."

Mbas dy vjetësh, duke njohur përgatitjen e tij të thellë, e transferojnë profesor në Kolegj të Troshanit, kurse më 1921 ishte, bashkë me Fishtën, Sirdanin, e gjithë hyjësine françeskane, u banë nismëtar të themelimit të Liceut të Shkodrës, "Illyricum". Studimet e tij gjuhësore filluan të mbushnin faqet e revistës "Hylli i Dritës", shpesh herë edhe në formë debati, e duke dëshmuar me to se askush tjetër nuk i njihnte si ai me themel si gegnishten, ashtu edhe tosknishten e deri tek arbërishtja e shqiptarëve të Italisë. Zotëronte

nuk e lëshoi makinën e shkrimit, duke punuar me vetmohim vetëm me dorën e majtë.

Justin Rrota ishte një ndër françeskanët më të shquar shqiptarë. Bashkë me Fishtën, Gjeçovin, Bardhin, Prennushin, Kurtin e disa të tjerë, që edhe bashkëpunëtor i zellshëm i revistave "Hylli i Dritës", "Zani i Shna Ndout" e të tjera. Ai, me bashkëpunëtorët e vet A. Xhuvanin, E. Çabejn e të tjerë, gjithë jetën e vet u përpoq me mish e me shpirt për gjurmimin e gjuhës dhe të literaturës shqiptare. Megjithëse i paralizuar trupit, me këmbëngulje dhe dashuri e flije të jashtëzakonshme, punoi për shumë vjet në detyrën e profesorit të gjuhës shqipe e latine dhe në detyrën edukator i rinisë françeskane. Me punën e tij arriti të ndriçojë thesare të paçmueshme të kulturës shqiptare.

Kontributi i Justinit ishte i shumanshëm, posaçërisht për studimin e gramatikës shqipe, të sintaksës, morfologjisë, të historiografisë tonë letrare dhe në veçanti për njohjen dhe studimin e autorëve tonë të vjetër, sikurse për Buzukun, Matrëngen e të tjerë, që hapi shtigje të reja në gjuhësinë tonë.

Ai ishte i pari, që më 1929 solli në Shqipëri tri kopje të fotografuara të Mesharit të don Gjon Buzukut nga e vetmja kopje që ruhet në Bibliotekën Apostolokë të Vatikanit, që do ta transkriptonte pas 40 vjetësh miku i tij, Eqerem Çabej. Botuar më 1956, "Hulumtimi dhe shënjime mbi Gjon Buzukun", në të cilin argumenton edhe preardhjen e autorit tonë ma të lashtë, prej Kraje, krahinë në përendim të liqenit të Shkodrës. Por rrezja e studimeve të tij përfshinë edhe autorët tanë të vjetër: Budin, Bogdanin, Bardhin, randësia e Kuvendit të Arbënit e të tera. Në vitin 1940, Instituti i Studimeve Shqiptare në Tiranë e zgjedh anëtar të tij, në cilësinë e lëvruetit të gjuhës. Në periudhën e mëvonshme, veprimtaria shkencore e Justin Rrotës bie, rrjedhojë e ardhjes në pushtet të regjimit komunist dhe të sëmundjes së rëndë që e shqetësonte prej vitesh[2].

Vdiq dhe u varros në Shkodër, më 21 dhjetor 1964. Pas vitit 1990, me përmbysjen e regjimit në fuqi, puna e tij vlerësohet, duke i dhënë titullin "Mësues i Popullit" (1994) me këtë motivacion: "Mësues i devotshëm e plot pasion. Ka punuar me përkushtim, duke dhënë një kontribut të shquar si gjuhëtar dhe studiues". Një vit më vonë, në 1995 mori titullin tjetër "Punonjësi i shquar i shkencës dhe i teknikës". Edhe Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" e nderoi me titullin "Profesor nderi" (1994)

Burimi: Wikipedia

Vepër me vlera jo vetëm historike e gjuhësore asht studimi i tij, ma i thelli i llojit, "Për historinë e alfabetit të gjuhës shqipe" (1936), në të cilin evidentohet roli i intelektualëve shkodranë në atë proces të mundimshëm që çoi në Kongresin e Manastirit, 1908, ku ndër 32 delegatët me të drejtë vote, pesë ishin prej Shkodre e me një

rol vendimtar në atë Kongres, si At' Gjergj Fishta, Dom Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi e Hilë Mosi.

Edhe pse në vitin 1925 ai u prek nga paraliza progresive, jo vetëm nuk e ndërpreu punën e tij kërkimore, por e shtoi atë, e për 39 vjet, deri një javë para vdekjes,

nuk e lëshoi makinën e shkrimit, duke punuar me vetmohim vetëm me dorën e majtë.

Një datë e shënuar, që tashme do sillet në kujtesë të brezave dhe nëpërmjet kësaj pllake përkujtimore dhe veprimtarisë, që zhvilloj Shoqata Atdhetare "Dukagjini" për 100 vjet- Arsim në Dukagjin dhe At' Justin Rrotes, me vendim Nr. 235, me 7 shtator 2017 ju dha tituli "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin", me motivacion "Për devocion e përkushtim të përherëshëm në fushën e arsimit dhe ngritjes së nivelit kulturor të bashkësisë dukagjinase".

**E paraqiti për botim
GJON FIERZA**

Agim Desku: “Heshtjet vrasin”

Nga Tefik Selimi – Agim Desku: “Heshtjet vrasin”, Sh. B. “Meshari”- Prishtinë, 2016. Nuk ka asnjë poet shqiptar që nuk ka shkruar për atdheun e tij. Fati i atdheut ishte i lidhur edhe me fatin e popullit. Ky fat i “pafat” i popullit, qe frymëzim i krijuesve tanë matanë e këtë anë të atdheut shqiptar që të hartojnë vargje apo forma të tjera shkrimore.

Pra, atdheu ishte mbi të gjitha. Atdheu, si kanë shtuar të tjerët, edhe ashtu si është, është atdhe. Dhe, s’ka asgjë më të vlefshëm se atdheu! Kush e ka atdheun, i ka të gjitha. Liria dhe atdheu janë vlerat më të shenjta të një populli. Janë sublimja e jetës.

Edhe Agim Desku, poet, atdheut dhe lirisë së popullit i ka kushtuar vepra të tëra me vargje. E tillë është vepra e po sa botuar poetike e Agim Deskut “Heshtjet vrasin”, e cilat vepër flet apo “rrëfen” etjen e poetit që ka ndaj atdheut, vlerës më sublime të jetës së njeriut tonë. Prandaj, Agim Desku është poet që vlerësohet lart nga të gjithë. Ai, kohës së fundit, po hapëron guximshëm në krijimin e vlerave hyjnore poetike. Pse jo?

Gjer më tani, ky krijues ka botuar këto vepra letrare: “Përshpëritje drite” (poezi), “Në cilin varg mbes” (poezi), “Dua të pi verë Çamërie” (2011), “Këngë Ilirishte” (2015), “Monografi për mësuesin Tahir Abazin – Berisha” (2015), po ashtu ka botuar një vepër poetike të përkthyer në gjuhën greke me titull “Rrëfej diellit” – Athinë 2015.

Si poet me vlera të konsiderueshme artistike e të mirëfillta arti, ai është shpërblyer me disa çmime, si janë: e fitoi çmimin e parë për poezi nga Konkursi letrar “Të Rinjtë e Çamërisë” (2012), e fitoi çmimin e parë për poezi “Të Rinjtë e Çamërisë” (2011), po ashtu, ai e fitoi çmimin e tretë në Manifestimin kulturor “Flaka e Janarit” në Gjilan në vitin 2012, u çmua si personalitet krijues në vitin (2012) në Vlorë nga Kongresi i “Rrjeti i Gruas shqiptare”. Po ashtu, ai në vitin 2014, mori çmimin e parë nga Konkursi i Flakës së Janarit në Gjilan për poezi dhe, në vitin 2014, ai fitoi çmimin e parë në konkursin “Poezia del populli në Milano të Italisë. Ky ishte opuesi i vlerave të artit poetik të tij. Jo vetëm kaq.

Thonë, poetët janë çudi e botës. Ata jetojnë me vargje, rima, strofa e me forma të tjera të artit poetik. Pse jo? Vetëm poetët e ndjejnë jetën më bukur se të tjerët. Nuk ka poet që nuk i ka kënduar atdheut, luftëtarëve, lirisë, historisë së popullit në përgjithësi. Edhe Agim Desku, atdheun, lirinë dhe luftëtarët e vendit nuk i ka haruar, përkundrazi, ai këto vlera sublime i ka përjetësuar në vargje.

Ditë më parë, Agim Desku, poet, doli

me botimin e veprës së radhës me poezi me titull “Heshtjet vrasin”. Është kjo një vepër me reflektime të mëdha atdhe-dashurie. Pothuaj, në secilën poezi, poeti e artikulon fjalën diell, liri, flamur, Skënderbe, luftëtar, Shqipëri etj. Ai në poezinë e parë shton kështu: “Nëse një ditë vije, ai është dielli që lind diellin e atdheut tim”(f.9). Apo, dielli që lind diellin, është jeta, liria, atdheu dhe fjala e mikes, që shndërrohet në shi loti dhe në shi Shqipërie”(f.9).

Ky është vokacioni i parë në veprën e tij poetike, nga i cili vokacion nuk mund të largohet poeti, sepse, tek ai është ngulitur dashuria ndaj atdheut, popullit e vlerave të tij. Me këtë vepër poetike, Agim Desku ka kënduar apo “rrëfyer” ngjarje, kohë e për të Bukurën e Dheut, ku thotë: “asnjë fjalë mos ma kërkë sot/ as dhimbjet mos

tij, ku shton: “Atdheu im më je sa herë të lexoj/ Lirinë ma sjell pranë kur ti bëhesh zjarr/ Dashurinë ma mësove kur kisha të vetmin mall” (f.11). Këtu është zjarri i poetit, i cili i gufon kënga e tij nga brenda. Dhe, prej krejt kësaj, poeti, duke kënduar, “shndërrohet në shi loti dhe në shi Shqipërie”(f.11).

Poeti nuk e harron marsin kryeneç, i cili evokon jetën, edhe në kohën kur ai ishte i vetmi ferr i Dantes, dhe nuk i harroi tokën e heronjve që “falën gjakun e lirisë”. Pra, poeti ishte një lloj vëzhguesi i “ngjarjeve” trishtuese e tragjike të popullit shqiptar që sapo kaluan dhe, tash i erdhi koha kur shton: “Së bashku me engjëjt ta bashkojmë tokën e shqipeve/ në një këngë që kurrë mos ta harrojmë as unë e as fisi im”(f.12).

nuk e di a ka dhimbje më të madhe/ sepse ai është dielli për secilin varg dheu” (f.21).

Fatin e atdheut poeti e “rrëfen” në vargjet e tij lirike. Ai haptas shton se, “Kurrë lirinë të bashkuar nuk e takova/ në asnjë cep atdheut Shqipërie” (f.27). Po ashtu, në poezinë “Nëse do isha i lirë”, poeti loton kur shprehet se, nuk vdiqa edhe kur do të duhej të vdisja. Sepse, këtë ndjenjë atdhedashurie e shpreh kur thotë se, lotët më ngrohin nëse do të isha i lirë, pra në atdheun e shqipeve apo në hyjnitë e zotit. Një kohë e kaluar, për poetët ka qenë “mollë e ndaluar”. Krijuesit kanë qenë të anatemuar dhe nuk kanë pasur guxim ta shprehin lirinë e fjalës ndaj atdheut dhe lirisë. Prandaj, edhe poeti në fjalë shton se, “mollë e ndaluar qenka vetë jeta ime”, sepse fati i tij qenka në pisk shpirti”.


Edhe Alma Feruni, vlerësuese nga Vlorë, lidhur me veprën e Agim Deskut “Heshtjet vrasin” shton se, vargje që rrjedhin natyrshëm nën sfondin e simfonisë së nëntë Beethovenit. “Vargje që rrjedhin natyrshëm, si burim i krojeve tona. Poeti bëhet mik me ndërgjegjen, vargëzim vargësh, hyjnor shpirti duke e ndier veten të lirë larg nga çdo robëri pasionesh e mëkatesh vdektarë”(f.140).

Florim Zeqa, recensent i veprës, shton se, “Poeti Agim Desku, në libri më i ri me titull “Heshtjet vrasin” shpëtimin e kërkon kudo në univers, tek yjet në qiell, tek dielli kërkon ngrohtësinë e shpirtit, hënës i kërkon të ndriçojë errësirën e natës, tek buri-

met e pastra të ujit pastrimin e ndërgjegjes shpirtërore”(f.141). Ai më tutje shton se, “Poetët e mëdhenj të përmasave kombëtare dhe ndërkombëtare, siç është Agim Desku, janë të rrallë, të thjeshtë, të sinqertë, me kulturë të lartë qytetare, me karakter të fortë njerëzore, të gatshëm të kapërcejnë të gjitha vështirësitë, vetëm për të mbajtur fjalën e dhënë, këtë e bëri A. Desku ...”(f.142).

Në fund të shtojmë se, poezia e Agim Deskut është një lloj kënge e kënduar me melodinë e zemrës, e cila rrënjët i ka tek atdhedashuria e njeriut tonë. Është poezi që ka ritëm e vlerë substanciale, sepse, aty-këtu vërehet në vargje zjarri i poetit që shpërthen dhe ngre zërin kundër heshtjes që vërtet. Poeti është për një ngritje të vetëdijes së njeriut që t’mos hesht, në kohën kur duhet vepruar. Epilogu i këndimit të kësaj vepre është: “O sa mirë me qenë shqiptar”

FLORIM ZEQA



m’i merr/ vetëm plagë të jetës shëro/ mos eja pa yjet poet/ janë fjala, jeta, kënga dhe vargu yt”(f.5). Këtu janë vlerat e poetit Agim, i cili, nëpërmjet gjuhës poetike, sikur publikisht shprehet gjer në egzaltim për ta adhuruar vargun poetik, i cili ia mundëson ta shpalos brendësinë e fortë të ndjeshmërisë së tij. Pra, këtu është reflektimi i krijuesit i tij si poet, i cili i drejtohet vargut, poezisë dhe hapet qartë e etshëm të rrëfejë atdhe-dashurinë ndaj krejt asaj që është shqiptare.

Në anën tjetër, tek kjo vepër poetike, poetin Agim Deskun e shohim duke adhuruar vargun e dhembshëm të Serbembes, sepse i kujtohen ato vargje të poetit mallëngjyes e tragjik, dhe shton se “ato ishin vargje hyjnish, që duhet thurur edhe ne pas ardhësit e tij vargje për shpirtin e tij”.

Mobi Casa

Vepra “Heshtjet vrasin” e Agim Deskut është një testament i vetëm i autorit, i cili, në asnjë herë të tjera nuk ka kënduar kaq bukur e kaq shpirtërisht e kaq dashurrisht ndaj atdheut. Në poezinë “Rrëfej të Bukurën”, poeti “rrëfen” për atdheun e

Poeti Agim Desku këndon nga thellësia e zemrës. Këndon dhe kënga e tij sikur ka mesazhe se, “Shqipërinë ende nuk e kemi në mendje si ta duam/ dhe do të rri me burra, por burrat ikën në përjetësi/ çdo ditë kërkoj burra e dheut e të atdheut të rri me ta”(f.12). Por, ajme! Poeti vajton e herë evokon të kaluarën e hidhur, e cila i ka lënë “mbresa” tek ai se sot, si shton, “mi ruani dëshmorët e lirisë”. Duke kënduar, poeti e “dëgjon” vargun naimian” kur shton “O këngë e zjarr, i vetmi mall/ e vetma fjalë që më rri në sytë e mirë o lum”. Është një këndim i brendshëm dhe i etshëm i poetit karshi atdheut dhe popullit të tij.

Apo në poezinë “Lëndimi” ka diçka nga E. Gjergjeku, kur shton “Ashti im edhe nga varri do ju mallkoj”. Këtu vërehet lëndimi i poetit dhe i të gjithëve, sepse, ka pasur kohë që kaluan dhe poeti shton se” më zihej fryma kur këngët kthejnë lotit” nga se, jeta e poetit ishte “korba para e korba pas ishte jeta ime”(f.19). Pra, gati secila poezi apo varg i Agim Deskut është një lloj kënge atdhetare, ku e thotë edhe në poezinë “Pengu i fjalës” se, “Për atdheun

DHUNA DHE KRIMI NDAJ GRAVE, RASTËSOR APO STRATEGJIK?

-BASHKËBISEDIM ME SOCIOLOGUN GËZIM TUSHI, "MJESHTËR I MADH"
DHE "KALORËS I URDHËRIT TË SKËNDERBEUT"-

FRAN GJOKA

Kohët e fundit në vendin tonë ka një "fluks" të madh dhune në familje, që i kapërcen të gjithë kufijtë. Dhuna në familje ka vërtetuar se abuzimi ndaj grave është një problem kompleks dhe shumë dimensional. Kjo lidhet dhe me faktorët kulturorë, shoqërorë, familjarë dhe individualë, që ndikojnë në mundësitë që gratë të bëhen viktimat të dhunës. Për këtë ju drejtuam sociologun Gëzim Tushi për të na e sqaruar më mirë, për lexuesin, këtë fenomen.

-Përsëritet Profesor!

Sot, jo vetëm në Shqipëri, por në shumë vende të botës ka një dhunë të shtuar ndaj femrave. Si e shpjegoni ju këtë dukuri të rrezikshme sociale?

GËZIM TUSHI - SOCIOLOG

-Po, është e vërtetë. Dhuna mbi gratë këtu në shoqërinë tonë, por jo vetëm, është bërë një "tumor social", që jo vetëm po zgjerohet dhe po bëhet "malin", por për shkak të gjerësisë dhe intensitetit të tij, duket si një dukuri e vazhduar kreshendo dhe e papërballueshme shoqërisht. Ne duhet të jemi të vërtetë dhe të mësohemi t'i pranojmë hapur gjynahet dhe "mëkatet" sociale të shoqërisë. Në këtë kontekst, në shoqërinë tonë fenomeni i dhunës mbi gratë ka shkaqet e veta me natyrë historike, ekonomike, fetare, politike, nacionale, kulturore, të traditës, tipologjisë së familjes, të cilat për një kohë që kur nuk mbahet mend është "ushqyer nga karburanti" regresiv i patriarkalizmit në familje, paternalizmit social maskilist, autoritarizmi gjinor dhe ideja e "privilegjit biologjik" të mashkullit mbi femrën. Dëmos dhuna dhe krimi mbi gratë ka edhe shkaqe komplementare me natyrë sociale e psikologjike. Unë jam marrë gjatë me këtë temë dhe jam munduar të bëj diagnostikime socio-psikologjike integrale e të diferencuara të kësaj dukurie. Të paktën në dy nga librat e mi "Martesa, Familja, Seksualiteti" dhe librin "Gratë në Kohën e Tyre" kam mundur të realizoj intervenime të shumanshme të thelbit, ontologjisë dhe fenomenologjisë dhe shkaqeve sociale të dhunës mbi gratë në familje e shoqëri, në jetën private e publike të tyre. Gjithnjë i udhëhequr nga parimi universal i sanksionuar në Konferencën e Pekinit se dhuna mbi gratë nuk është difekt dhe problem kulturor, por është problem politik dhe akt kriminal, që duhet parë, vlerësuar dhe trajtuar si i tillë. Optika e shikimit dhe trajtimit të ontologjisë dhe fenomenologjisë së dhunës, krimi dhe dëmtimit të statusit qytetar të gruas duhet parë në kompleks, si dukuri që lidhet me mungesat e barazisë në familje, me paragjyki-

met e shfaqura në mënyrë evidente për seksualitetin e gruas, me ekzistencën e korracuar të maskilizmit të maskuar pas aureolës së vjetër të konceptit të deformuar të burrërisë e lidhur me biologjinë e dhunës mbi gratë. Unë mendoj se duhet të jemi të vërtetë kur analizojmë dhe diagnosticojmë këtë patologji sociale, sepse heshtja, eufemizmi, mungesa e vlerësimeve reale ka bërë që për fat të keq, këtu në Shqipëri, por edhe në vende të tjera, duket që batica e dhunës dhe krimi mbi gratë në familje dhe shoqëri është bërë tejet shqetësuese. Nëse analizojmë në mënyrë të sintetizuar shkaqet e kësaj situatë të vështirë të gruas në Shqipëri, shfaqet e inferioritetit të statusit gjinor, ndikimet e koncepteve deterministe me natyrë biologjike e seksiste, apo me ndikimin historik të paragjykimit të përgjithësuar, bazuar në sintagmën e Frojdit se "anatomia është fati i gruas", konkluzionet do jenë të sipërfaqshme dhe "terapitë sociale" për të shëruar këtë patologji do jenë të dështuara. Shpeshherë këto "ilacë", që vijnë nga media, politika, shoqëria civile, shkolla, institucionet fetare ose nuk janë adekuate për shërimin e kësaj sëmundjeje ose në shumë raste janë me keq se sëmundjet gjinore që qarkullojnë në shoqëri dhe jetën private e publike të grave dhe vajzave tona. Sipas mendimit tim, konkluzionet e studimeve të mia më kanë çuar në një konkluzion më të përgjithshëm dhe përgjithësues të shkaqeve të dhunës dhe krimi në familjen shqiptare. Ato mund t'i klasifikojmë si shkaqe Makro, Mikro dhe të Personalizuara. Të parat janë historike, kulturore dhe ekonomike të lidhura me të kaluarën historike të shoqërisë, të dytat, faktorët mikro kanë lidhje me specifikat e tipologjisë së familjes konkrete, nivelin e kulturës dhe edukatës familjare, tipologjinë historike të familjes patriarkale dhe mungesës së gjatë të procesit të demokratizimit gjinor të familjes. Më në fund janë shkaqet e personalizuara të sjelljes individuale që prodhojnë dhunë mbi gratë për shkak të problemeve të shëndetit mendor të mashkullit, zgjerimit të përdorimit të alkoolit, drogës, bixhozit, nivelit arsimor personal apo "infeksionit" që shoqërohet me shfaqjen e tipareve të dembelizmit, përtacisë fizike e mendore, që i bën ata parazitë "par excellence" për të jetuar në kurrzin e grave të tyre. Por ka dhe një shkak social, që kohët e fundit është bërë epidemik. Shoqërisë shqiptare po i shtohen njerëzit e paekuilibruar dhe me instike e impulse të sjelljes vrastare. Në këtë situatë duket sikur përveç këtyre shkaqeve për nivelin e lartë të dhunës mbi gratë ka dhe dy faktorë që në shoqërinë tonë duket sikur janë "aleatë të krimi" mbi gratë. Ato janë zgjerimi i një lloji indiference qytetare që buron nga kon-

cepti i gabuar se dhuna mbi gratë është "çështje e jetës private", ku nuk na lejohet "ndërhyrja apo denoncimi publik". Dhe së dyti, është shfaqja e një lloji justifikimi të "forcës goditëse" të ligjit" në emër të gjoja respektimit të të drejtave të njeriut. Ka një ekuacion të njohur: krimi në familje gjallërohet pikërisht në momentin kur dobësohet apo zbutet ligji". Personalisht mendoj se duhet të mendojmë jo thjeshtë në mënyrë kapilare dhe rast pas rasti për dhunën dhe krimin mbi gratë, por në mënyrë strategjike, duke e futur shoqërinë shqiptare në fazën e ngutshme të një procesi social masiv të "dekriminalizimit

njeri).

Një faktor tjetër me natyrë pak gjeopolitike është e lidhur me faktin që jetojmë në një rajon të veçantë, sikurse është Ballkani, i cili e ka patur të konsoliduar historikisht si "ideologji" fikse një lloji kornize të kufizuar për pozitën e femrës dhe statusin e femërores në përgjithësi. Gjithnjë kam menduar se kjo patologji është sintetike dhe sinkretike, me influencë fundamentale mbi gratë, pozitën e tyre familjare, personale e publike. Sepse familja dhe shoqëria akoma prodhon disa "acide toksike", që janë frenuese dhe jo pohuese për pozitën e gruas në shoqëri, të cilat i



social". Jo vetëm për fatin e gruas, por për të siguruar një paqe të qëndrueshme sociale për të gjithë shoqërinë.

-Në vendin tonë, kjo dukuri, kohët e fundit, ka një përhapje si të thuash si një epidemi. A mendoni ju se diku "fshihet" një "virus" social, si një ndërvarësi dhe koordinim në nivel molekular dhe qelizor të shoqërisë sonë të traumatizuar?

-Ka një debat sociologjik sot lidhur me shkaqet e dhunës dhe krimi mbi gratë. Debati është një "ekuacion me dy kahje". Thelbi është ky: Dhuna mbi gratë është produkt gjenetik dhe e metë e species mashkullore apo është faj i kulturës dhe pasojë e rrethanave sociale? Pikërisht nga që dhuna, padrejtësia dhe pabarazia për gratë është e lidhur, përveç të tjerave, edhe me njollat e forta kulturore maskiliste, shoqëria shqiptare po kalon një moment delikat dizekuilibri me "veten", strukturat sociale dhe individët që i përbëjnë ato.

Në jetën e përditshme, në familje e shoqëri po shfaqet "njeriu bishë", që përdor dhunën me lehtësi dhe bën krime me gjak të ftohtë. Një bashkëjetesë paradoksale e njeriut të arsyeshem (homo sapiens), që për fat të mirë përbën shumicën e shoqërisë, nga njëra anë, dhe shtimit të njeriut agresiv, që nuk është qenie racionale e as vepron me arsye, por me instiktet e dhunës dhe krimi, që janë tipike për "njeriun e neandertalit (atë që ndali evolucionin dhe nuk arriti të humanizohej si

frenojnë gratë që të kenë frikë nga lufta për sukses individual, autoritet social publik në familje e shoqëri apo nën efektet e "kornizës së ngushtë" të femërores, ato në vend të luftojnë për afirmim personaliteti, e kanë më të lehtë të nënvleftësojnë veten.

-Qeliza bazë e një shoqërie është familja. Çfarë po ndodh në familjen shqiptare dhe cilat mendoni ju se janë faktorët që e ushqejnë këtë dhunë jo vetëm psikologjike, por deri në eliminim fizik të grave?

-Familja shqiptare, në procesin e transformimit demokratik dhe krijimit të kushteve për shfaqjen e vërtetë të barazisë gjinore, në disa raste duket se ecën në kundërsens apo shfaqet si një institucion i "dalë nga shinat" gjinore. Për fat të keq dhuna në familje, në jo pak raste, e ka bërë shtëpinë si "burg" për gratë. "Llumi" social i dhunës dhe krimi është trashur deri në nivelin që po i zë "frymën sociale" grave dhe vajzave tona. Ne duhet ta pranojmë se disa familje kanë krijuar një klimë asfiksuese për lirinë dhe të drejtat e grave. A mund të flitet për barazi gjinore në kushtet kur familja dhe shtëpia janë bërë "shkollë" ku mësohet dhe aplikohet despotizmi maskilist dhe ku është e vazhduar dhuna sistematike e meshkujve mbi gratë? Në këto familje ku aplikohet dhuna, është e sigurt që femrat nuk kanë dhe nuk mund të kenë statusin e qytetares së barabartë. Për fat të keq, akoma kemi

meshkuj që kanë në mendje mentalitetin mesjetar, sipas të cilit "gruaja është pronë e burrit", se ai mund të bëjë çfarë të dojë me të, se ai është njeriu që ka të drejtë të vendosë kufirin midis asaj që i "lejohet" dhe asaj që i "ndalohet" gruas së tij. Jo të gjitha gratë janë "metropolitane" të guximshme e mendjehapura apo që e kanë kapërcyer "diferencën maskiliste" me profesionin. Akoma shoqëria jonë, në zona të caktuara, është sundues koncepti që kufizon spektrin e të drejtave të grave, nën peshën e sintagmës së vjetër tradicionale të gruas së mirë si "zonjë shtëpie". Është e vërtetë që paradoksalisht sasia më e madhe e dhunës dhe numuri më i lartë i krimeve, vrasjeve, por dhe vetëvrasjeve të grave ndodh në gjirin e familjes. Shkaqet janë të shumta, sikurse mund të përmendim mungesën e komunikimit, prishjen e lidhjeve emocionale, xhelozitë delirante, dështimi i lidhjeve sentimentale të martesës, përplasja e kornizave kulturore për evolucionin dhe ndryshimin e tipologjisë së sjelljes etike të grave dhe vazave në kushtet e emancipimit të përgjithshëm të shoqërisë etj.

Padyshim, situata e divorcit, me shkaqet të vërteta esenciale apo me gjykime të nxituara apo paragjykime flagrante për seksualitetin e femrës, janë bërë shkak që të shtohen divorcet duke i bërë lidhjet dashurore të përkohshme. Nuk është problemi thjeshtë tek divorci. Sa kohë që ka martesë, do ketë dhe divorce, si një mjet për të zgjidhur në mënyrë civile dhe me humanizëm një lidhje që nuk funksionon, një martesë të "ndryshkur që nuk lubrifikon dhe nuk jep produkt pozitiv". Problemi është se në familjet tona, situatat e para, gjatë dhe pas divorcit, janë tejet problematike. Ato prodhojnë konfliktualitete të forta, të thella, të zgjatura, që në shumicën e rasteve shoqërohen me dhunë të vazhduar, intensive e të agruuar. Shpeshherë edhe me përfundime kriminale e vrasjen apo vetëvrasjen e grave. Ne nuk e kemi kulturën e duhur të realizimit

të "divorcit miqësor", me mirëkuptim dhe zgjidhje të partneritetit bëshkëshortor pa shpifje, intriga, thashetheme dhe dhunë verbale apo fizike. Është bërë shqetësuese prania në shumë raste e mashkullit të dhunshëm, që shikon interesat personale dhe kultin e vetes dhe harron të drejtën e ekzistencës së barabartë të femrës së tij, në çdo status qoftë: si nënë, motër e dashur, bashkëshorte, etj. Kjo situatë e bën imperative nevojën e demokratizimit të familjes dhe krijimin e konceptit konsensual, që e konsideron dhunën mbi gratë një turp social të pajustificuar. Sepse ne duhet të krijojmë atë kulturë tek djemtë dhe burrat tanë, të cilët duhet ta perceptojnë thellë dhe thelbësisht të vërtetën se nuk mund të jetë qytetare një grua që jeton në një familje ku ka vetëm dhunë dhe seks të alternuar. Familja, shkolla, shoqëria civile duhet të bëjnë gjithçka për të edukuar sjelljen e përshtatshme të djemve dhe meshkujve ndaj femrave dhe grave. Deviza e përbashkët e të gjithë institucioneve të parandalimit, mbrojtjes, edukimit dhe ndëshkimit të dhunës mbi gratë duhet të jetë teza se niveli i dhunës mbi gratë është shprehje e nivelit të qytetërimit tonë.

-Çfarë mendoni ju se duhet të bëjnë institucionet shtetërore dhe shoqatat e ndryshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe ato të të drejtave të gruas në veçanti?

-Të gjithë sociologët, më saktë, shumica prej tyre, ku bëj pjesë edhe unë, në fund të shekullit të kaluar kemi besuar se shekulli ku jemi do të sillte përmirësime të gjithanshme të pozitës private dhe publike, familjare e sociale të femrës. Në fakt duket se "grushti i hekurt" i maskilizmit është akoma shumë i fortë. Për pasojë dhuna dhe krimi mbi gratë në shoqërinë shqiptare nuk është problem social anësor, por kryesor dhe me peshë. Fenomeni më i dukshëm, i urrejtjes që ka shfaqet më të hapura dhe më banale dhe që për shkak se shfaqet në gjysmën e shoqërisë, është dhuna fizike, psikologjike e seksuale

ndaj femrës, që ka si bazë urrejtjen për shkak të gjinisë dhe specifikes gjenetike të saj. Në shoqërinë shqiptare gratë janë dy herë viktimë, një herë për të njëjtat shkaqe si burrat (grabitja, vjedhja etj.) nga ana tjetër edhe për shkak se janë femra. Nuk besoj se dyshon kush që në vendin tonë kjo urrejtje patologjike për gruan shfaqet si dhunë verbale, përdorim pa kriter i gjuhës së seksit, si ngacmim seksual në rrugë, ambiente publike e në ndonjë rast edhe në ambiente zyrtare të punës, pse jo, deri në përdhunim, sulm apo vrasje. Me fjalë të tjera, gratë në vendin tonë (por jo vetëm tek ne) shfaqen dy herë të dhunura si njerëz dhe si femra. Kjo e dyta si dukuri, të paktën në shoqërinë shqiptare buron nga urrejtja dhe koncepti primitiv, sipas të cilit, femra është objekt i destinuar për ngacmim seksual. Në këtë paragjykim të zgjeruar kanë ndikimin e tyre jo vetëm rrjetet sociale, ku qarkullon një "limfë e dendur" paragjykimesh maskiliste, por edhe në shumë filma e spektakle argëtuese shfaqen fenomene të diskriminimit gjinor. Për fat të keq, ato nuk po shërbejnë si "vendet e duhura" ku mund të kultivohen dhe propagandohen normat e drejta shoqërore për marrëdhëniet ndërmjet gjinive.

Kjo është e nevojshme, sepse sipas statistikave të OJF-ve në Shqipëri, të dhëna të medias së shkruar dhe elektronike, të policisë, krimet e dhunës ndaj femrës kanë përgjithësisht si bazë psikologjike e sociale urrejtjen mashkullore për shkak të gjinisë. Shumica e përdhunimeve të kryera nga meshkujt shqiptarë nuk bëhen nga dëshira seksuale personale për një femër të caktuar, por shpesh shumë meshkuj e kanë realizuar krimin e përdhunimit, vetëm nga paragjykimi se ajo (femra) është objekt i dobët fizik, i destinuar për të kënaqur epshet shtazarake. Pavarësisht se cila është ajo si identitet nominal. Analiza e rasteve të dhunës dhe përdhunimit të bind se përdhunimi i femrës ka për bazë ndjenjën e urrejtjes dhe jo të dashurisë,

të sadizmit dhe jo të seksualitetit mashkullor. Padyshim organet shtetërore dhe sidomos politika ka role dhe përgjegjësi të drejtpërdrejta që shpjegojnë këtë situatë të gruas në familje e shoqëri dhe sidomos të nevojës për përmirësimin e saj. Problemi nuk është vetëm kulturor dhe psikologjik, por i gjithanshëm dhe i shumanshëm. Përfaqësimi politik dhe barazia e grave në institucionet e vendimmarrjes është një konditë "sine qua non" për përmirësimin e statusit të tyre publik. Doemos të dukshme janë përfitimet gjinore që lidhen me rritjen e nivelit të punësimit të tyre. Punësimi i tyre nuk është thjeshtë mjet për sigurimin e të ardhurave të tyre, por domosdoshmëri për të garantuar statusin dhe përfitimet sociale që vijnë nga rritja e pozitës dhe pavarësisë së tyre. Sociologjikisht është e pranuar dhe e vërtetuar se arsimimi dhe pjesëmarrja në fuqinë punëtore, apo punësimi janë kusht për zbutjen e paragjykimeve dhe stereotipave gjinore. Gjithashtu është detyrë e politikës dhe qeverive në këtë vend që të rishikojnë më seriozisht nivelin e politikave gjinore, bashkë dhe në të njëjtën kohë me përmirësimin e legjislacionit, që është specifikisht i lidhur me pozitën dhe problematikat gjinore. Forcimi i institucioneve sociale të parandalimit dhe rehabilitimit të viktimave të dhunës, duhet konsideruar si detyrë e dorës së parë. Mbi të gjitha politika, qeveria, shkolla, familja, institucionet fetare dhe shoqëria civile duhet të ndryshojnë ritmin, mënyrat dhe modalitetet e edukimit gjinor. Mbi të gjitha, tani është koha e duhur për t'i perceptuar çështjet e dhunës dhe krimin mbi gratë, nga një problem personal dhe privat, në një çështje të madhe politike, publike e kombëtare.

- Profesor, ju falënderoj për bashkëbisedimin
- Dhe ju gjithashtu!

*** KURIOZITETE *** KURIOZITETE *** KURIOZITETE *** KURIOZITETE ***

Si u bënë gomari dhe elefanti simbole të demokratëve dhe republikanëve amerikanë?

Dy partitë kryesore në Shtetet e Bashkuara kanë dy kafshë të ndryshme si simbole të tyre.

Gomari është simbol i Partisë Demokratike, ndërsa elefanti është simbol i Partisë Republikane.

Këto dy kafshë janë pjesë e rëndësishme e fushatës së tyre elektorale. Por, pse pikërisht gomari dhe elefanti?

Të dy partitë kanë nga një simbol kafshësh: gomari për demokratët dhe elefanti për republikanët. Simbolet i sheh kudo: në kapele, stema, bluza dhe filxhanë.

Por, si erdhën deri tek këto simbole?

Fillesat janë gjatë fushatës elektorale të Presidentit Andrew Jackson më 1828.

Kundërshtarët e tij e shanin duke e quajtur 'gomar'. Por, Jacksoni qeshi i fundit. Ai e bëri gomarin pjesë të fushatës së tij – dhe fitoi.

Karikaturistët ishin ata që e përjetësuan lidhjen e demokratëve me gomarin.

Më i famshmi ishte Thomas Nast, i njohur si "Babai i filmave vizatimorë ameri-

kanë".

Ai përhap edhe elefantin si simbol të republikanëve. Vizatimet e tij satirike u botuan në gazetën "Harper's Weekly" në vitet '70.

Por elefanti republikan është shfaqur shumë më herët në gazetën e fushatës pro-Linkolnit, "Ati Abraham".

Një elefant mban lart një pankartë për të festuar fitoren ushtarake të Unionit.

Në Luftën Civile shprehja "të shohësh elefantin" nënkuptonte pjesëmarrjen në betejë dhe rrezikun që vjen me të. Me kalimin e viteve lidhja e republikanëve me elefantin është forcuar.

Presidenti Gerald Ford dhe gruaja e tij, Betty, kishin një "dhomë elefantësh" në shtëpinë e tyre në Kaliforni.

Më 1984, Presidenti i Sri Lankës i dha Presidentit Ronald Reagan një elefant të vogël.

Sot, republikanët e shohin elefantin si simbol zyrtar të partisë së tyre./VOA/

Gënjeshtra e famshme e 1 Prillit, që mbeti në histori

Më 1 prill 1957, ndodhi padyshim një

nga mashtrimet më kurioze të bëra ndonjëherë në histori.

U krye nga Richard Dimbleby, një gazetar i BBC-së, producent televiziv dhe radiofonik.

Me një sens humori të shtuar dhe të veçantë më 1 prill 1957 ai prezantoi një raport unik për pemët që prodhojnë makarona.

Gazetari tregoi në një dokumentar padyshim të rremë anëtarët e një familjeje italiane që mbledhin makarona nga degët.

Dhe bindi britanikët se makaronat rriten në pemë.

Menjëherë pas transmetimit të raportit, shikuesit britanikë po kontaktonin BBC-në për të pyetur se si mund të merrnin disa rrënjë për të mbjellë pemët e makaronave.

Por çfarë është 1 prilli dhe nga e ka prejardhjen?

Dita e 1 prillit dikur festohej si dita e Vitit të Ri, por me ndryshimin e kalendarit nga Julian në Gregorian, në 1582 nga Papa Gregory XIII, dita e Vitit të Ri u vendos më 1 janar.

Por disa njerëz vijonin të gënjenin

veten dhe e festoni këtë ditë më 1 prill, ndërsa të tjerët talleshin me ta.

Të tjerë thonë se gjatë sundimit të Kostantinit, një shakaxhi i quajtur Kugel i tha perandorit se ai mund ta drejtonte më mirë perandorinë.

Kostantini e mori me të qeshur këtë gjë dhe e lejoi Kugel-in të bëhej perandor për një ditë, në datën 1 prill, të cilën Kugeli e shpalli ditën e gënjeshtrave.

Ky shpjegim u publikua në vitin 1983 nga Associated Press, por kishte një problem.

Autori gjithashtu e kishte trilluar këtë gjë për të bërë një shaka për 1 prillin.

Associated Press u kërkoi falje lexuesve. Sot 1 prilli festohet në Europë si Dita e Gënjeshtrave dhe njerëzit bëjnë rrengje dhe shaka me njëri-tjetrin.

Shakaja më e çmendur konsiderohet ajo e një gruaje amerikane që u arrestua nga policia, pasi deklaroi se kishte vrarë burrin e saj.

Gazeta "DITA"

Krisi pushka them në thep...

SE KTU I THONË MËRTUR E SHALË
T'LANË ME HI E S'T'LANË ME DALË.

Referuar luftës kundër shqijeve në vitet 1914-1918.
(Shkruar nga Gjon Bale Progni, Bruksel, më 22 shtator 1957)

Ngusht kish ra e shkreta Shalë
Armet Italia ua kish marrë,
Jau kish marrë, jau kish farue
Pak e të mshefta ju kishin qillue.
Larg prej shpijash i kishin mlue,
Shpejt po shkojnë me u shtrëngue,
Pushken Savës me ia fillue.
Shife Sava sa kopil.

N'at qafë të Agrit kur janë afrue,
Shala mbrapa u ka vendue,
Njaj Kolë Marku një zog petriti
Një mijë shkive pushkën ua nisi
Me Ujkë Lulashin e do shaljane
Vjen Pep Ndreu një trim si zanë,
Asht ndezë qafa në t'katër anë.

Në t'katër anët u qit potera,
Shpejt duel Salca në ato lera,
Vend kanë zanë në ato dëllinja
Po vjen shkjaun porsia subia,
Për me i hy Salcës nër shpia,
Ai Pal Ceka fort pisket
Nдалu Savë, se ktu s'del kali
E ke lshue tepër së gjati.

Krisi pushka njati shpati
Ushtojnë majat në të katër anë,
Shpejt po vijnë Shoshi me Toplanë.
Savë Batarja, djalë i krajlit,
Tash më duel fjala e Tunxh Miftarit,
Që m'pat thanë, ka pata ardhë
Se këtu i thone Mërtur e Shalë
T'lanë me hi e s' të lane me dalë,
Ma paska thanë fjalë të drejtë
Kërciti pushka thep në thep.

Ç'po lufton kjo Salca e shkretë
Më armë të mshefta e pak fishekë
Me një pushkë luftojnë dhet vetë,
E ruajnë shkjaun kur shoqi e vret
Po i kërcen tjetri shpejt e shpejt
I merr pushkë, i merr fishekë.

Bub Matoshi një djalë i ri
Po m'i kcen shkjaun përmbi,
I muer manxerre, i muer allti,
Gjokë Sadria si arushë,
Ç'po mu del shkive për fushë,
Shumë po vret, po u merr pushkët,
N'at shpat t'kryqit, n'rrenzë t'nji dllisë
Bukur qiti zogu i shkinës,
Mirë mja ngjiti Gjokë Sadrisë
Gjokë Sadria një djalë i ri
Në shenjë për dokë e për trimni
Njizet vjet hala pa i mbrri
E dha jetën për shqipni.

Shumë ka ndejë Gjoka pa dekë
Babës s' vet ç' po m'i bërtet,
Qindro babë e ban gajret,
Kurrë ma mirë nuk kisha dekë
Plot nja tetë i kam vra vetë,
U kam marrë pushkë me fishekë.

Gjokë Sadria pshtet për thep
Shokve t' vet ç' po mu pisket
Bini shokë, bani gajret
Se nuk muj ma me u ndjek,
Pushka kambën ma ka Tretë.
Se ka thye gunin përmyet.

Pal Raja ndenjë mbi thep,
kush ma mirë me pushkë nuk qet,
Gjaksin Gjokës shpejt ia vret,
Kur ndien zanin e Gjokë Sadrisë
Sulm kanë ba djelmt e Shqypnisë
Kanë gjimue Lera e Karroni
Thepi i kryezes, Lera e Okolli.

Bume e pushkë kërcet pa nda
Ç' janë përzie shqiptarë e shkja,
Ç' po thërret zani në krye të Karronit
Bini djem e mos e lshoni,
Se ka mbet Pal Mirash Shoshi,
Si Gjokë Mirashin një Shaljan,

Bini shokë e mos me e lanë,
Se m' ka marrë pushka në kambë.

Djelt e Shalës fort janë idhnue
Turr mbi shkiet atëherë janë çue
Gjak u mblun Lera e Karroni
Thepi i kryezes, Biga e Okolli,
Pjeter Deda hallakati
Bini djem me dorë me i kapë,
Fort për luftë e kish zanat,
Turr po i ndjek përmbas,
Mark Zogu si Ded Mëhilli,
Lulash Sokoli, djelt e Salcës ngasin Karronit
Si Langoi mbas kaprollit,
Si Ndue Deda e Dedë Sadria ,
vjen Nosh Luci si stuhia,
Ai Vatë Çuni mustakzi
Ç'po lufton Doda I Prelë Tullit,
Me do djem ai nuk e dronë plumbin,
Ai Ndue Noshi e ai Zef Pali
Gjon Sokoli e Zef Hajdari.

Qerim Delia po rrin në thep,
Kur po i sheh me sy po i vret,
Për trimni e kish adet,
Ish shpi pushkë gjet me gjetë,
Gjelosh Kola ç'po pisket
Bini burra t'bjamë gajret,
Se i kem thye, po himë përpyetë.


Marash Tushi një burrë i gjatë
Ç'po mi nep francezes flakë,
Hajt franceze e paç nafakë,
Dymbdhjet vjet t'kam ruejt në arkë,
Nuk t'kam lanë me t'pa xhandari,
as me t'marre ska mujt taljani,
Mirë mja ndie krismën serbjani.

Kush lufton në kodër të Murovit
Sokol Zefi e Lulash Gjoni,
Kush po i ndjek bjeshkës përpyetë,
Zef Delia me shtat a tetë,
Do xen gjallë, shumë kanë dekë,
Me Gjon Kokrrin e Pal Ukë Çunin,
kin prej Tetajsh Mark Zenunin ,
Nje djalë trim që s'e dron plumbin.

Kush po i ndjek në ato brinja
Ukshin Marashi e Nikë Delia,
Kush po i ngjun në ato prronj
Lepur Marashi e Marash Ndoj,
Isuf Sadiku faqja e bardhë
Shpejt prej Currajsh paska ardhë,
guj për guj lufton me dajë,
Atëherë shkijet të tanë kanë ikë
Kush la kryet, tjetri theu britë.

Këta shqiptarë zoti m'i rritë
Nji me njiqind dalin në pritë,
Me ba luftë si me t'habitë
Sikur bukra e pret mitë
Ashtu shkiet i bani kët ditë.
Kapitani kenka koritë,
Ka lanë shokët e vet ka ikë!

E paraqiti për botim
BESIM PROGNI



*** Poezi nga Elvira Zeneli dhe Kumrie Avdyl Shala ***

DITË VERE E NGRYSUR

Erdhi përsëri kjo ditë vere
Dhe sa të tilla do venë e do vinë
Në oborrin e shtëpisë ku më priste babai shkova,
Pluhuri kishte mbuluar çdo gjë,
Dimri vrarë e kishte atë vend.

Kajsia para portes kishte çelur
Më thoshte eja pranë meje se unë po të pres
Lulet për ty i çela
Të kujtosh gjithmonë tët ét.

Zërin e tij aty e kishte lënë
Më vinte në vesh...shiko moj grua, dil kush erdh'
E shtrenjta e babit ma zbukurove këtë ditë vere
Oborrin ma mbushe më gëzim e hare,
Me nipin e mbesat që m'i solle...

Oooh Zot sa qetësi,
Heshtje kudo në çdo vend
Askush nuk po më pret as tek shtëpia e babit
E as në lagje ku heshtja ka zënë vend
si një hije e zezë dhe e rëndë.

Në pragun e derës u ula
Pluhurin e lava me lotët e mallit
Tani vetëm shkova
Fëmijët m'u rritën, kanë marrë rrugën e vet...

As zërin e mamit nuk e dëgjova
Iku dhe ajo tek bijtë e saj,
Pa prag më la, pa më pritur
Nuk e mendonte se një ditë drynit shtëpinë testament ia la.

Ikën të gjithë,
Unë rri e i pres për ditë vere e ditë moti
Kujtimin e tyre marr udhës sime
Ushqim per shpirtin e përmalluar e të lodhur
As dorë njeriu që hap portën,
As Konstandin që çohet dhe merr motrën.

ËNDËRR E ËNDËRRT

Në çdo fjalë tënden ndjeva mall,
Dridhjet e zërit ti dëgjova
Si telat e kitarës prej vajit të heshtur,
Po sot e ndjeva më tepër dashurinë
Që ma kishe mohuar që moti!

Pashë në ëndërr ëndrrat e dikurshme
E rigjeta puthjet e humbura
Që më prangosën sërish në krahët e tu.
Sa shumë më paske munguar!

Ti je mungesa ime
Nën dritën e mekur të muzgut
Duke u lutur më kot
Që dielli të rilindë sërish
E ëndërra të bëhesh Ti!

Jam përtej natës dhe heshtjes,
Diku aty përmidis
Ku dëgjohet zëri i shpresës.
Veten time e lashë të kapur pas dritës tënde!

Nuk dua te jem motiv i humbur
I një mallkimi të ditës pa kthim
Kur ti ike në askund!

Nën grilat e qerpikëve
Fle ëndrra ime për ty
Që më erëmon çdo natë
Duke u lutur të shohë ëndrrën tënde
Që në mëngjes të më bëhet portret ëndrre,
Ëndërr brenda ëndrrës!



U SHKAPËRDERDHËM

E shkapërderdhëm dashurinë nëpër botë,
Njëherë në vit po mblidhemi në dhomën e moçme
Se, vetëm përvjetoret po na bashkojnë.

E rëndë është kur dashnitë i merr era.
T'i qash apo t'i gezohesh ikjës,
kur çdo ditë dhomës së moçme
i shuhet nga një kandil
e, ne shtangemi nga mërzia.

Janë shperndare lejlekët,
strofulla më nuk po ndërtojnë,
as qukapikve nuk po ua ndegjojmë krismën
ashtu sikur para do viteve.

Është shkapërderdh dashuria e hershme,
Tash, edhe me dashte, ke frikë
se, lejlekët kanë nuhatur ngrica
në Bjeshkën me (Name) Lumnueme.

OXHAKU I BABËS

Erdha këtu t'jetoj këtë pak jetë
që më ka mbetë
në pjesën e shpisë sime e të babës

Ti që pate parregullsi në kullosat e mia me vite
e arat m'i shfrytëzove pa më pyet
bëje pushkën top n'daç me e ba, se unë erdha
Dhe nga tashmë këtu më ke

Rrugët e emigrimit mjaft më plakën
Kokën ma thinjën si dëborë në malet e Lubotenit
e në grykën e Zhlepit,
por mëndjen e dëshirat nuk mi
ndërruan për atdhe.

Edhe pse rininë ma shtrydhi,
ndrydhi e ma vodhi emigrimii,
deri n'asht më t' kurri e më krrusi pa mëshirë
Gjakun me pambuk ma thithi
Por mëndjen nuk ma ndërroi kurrë
që të kthehem në kullat e mija

E tani u ktheva në truallin ku më ka lindë koka
në gjirin e tij më shtrëngoi fort nga malli
Këtu s'do ketë më parregullsi, në livadh e në arat e mia
Se kjo tokë e ka të zotin e tij

Erdha me vdekë në pjesën time në atdhe,
Këtu rrëzë pishës së madhe, afër fisit tim, dua me më shti
në dhe...
U ktheva në kullat e oxhakut të babait tim
Përgjithmonë këto troje ku kam le, mos t'i lë shkret.



REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli,
Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani,
Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:
Zotni LISANDRI KOLA,
me banim në SHBA

